



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 3/2023 regjistër (JR)
Datë 17.01.2023

Vendim nr. 14 (JR)
Datë 15.04.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 15.04.2024, ditën e hënë, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 3/2023 (JR), që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 592, datë 24.11.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Erion Pano.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e ngritura nga Komisionerja Publike Irena Nino në ankim, në parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare para Kolegjit, me anë të të cilave kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 592, datë

24.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit Erion Pano, me anë të të cilave kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Erion Pano për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 3, pika 16 të ligjit nr. 84/2016, iu nënshtroa procesit të rivlerësimit *ex-officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
3. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Erion Pano¹, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar si vijon:
(i) *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor.*
(ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
(iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
(iv) *Nuk ka kryer deklarim të rremë.*
(v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”)², në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, në raportin e përcjellë në Komision ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në përfundim, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Erion K. Pano.
5. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 03.04.2018.

² Raporti me nr. {***} prot., datë 31.10.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror” nr. {***}, datë 27.10.2021.

ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv e rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga organet ndihmëse, siç janë pasqyruar më sipër, kreu hetimin administrativ dhe përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 592, datë 24.11.2022.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin³ nr. 592, datë 24.11.2022, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Erion Pano, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.
8. Ky vendim është bazuar në nenet 58, pika 1, germa “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

8.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: *Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Erion Pano ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka kryer deklarime të sakta në deklaratën “vetting” dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme, apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklarime të rreme. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në ndonjë rrethanë të konfliktit të interesit. Veç këtyre, për një vlerësim pozitiv të kriterit pasuror, Komisioni çmon me rëndësi faktin se në lidhje me këtë subjekt rivlerësimi, janë kryer hetime të thelluara edhe për deklarime të kryera pas deklaratës “vetting”, pikërisht në funksion të krijimit të bindjes së brendshme në lidhje me saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve të kryera përpara kësaj deklarate nga ana e subjektit dhe personave të lidhur. Nga hetimet, rezultoi se çdo deklarim pas deklaratës “vetting” ka qenë në koherencë të plotë dhe në vijueshmëri të deklarimeve që nga viti 2005, kur subjekti ka rifilluar të ushtrojë detyrën e prokurorit, e deri në deklaratën “vetting”. [...] Në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*

8.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: *Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit Erion Pano arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera, nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. [...] Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

³ <https://kpk.al/wp-content/uploads/2022/12/Vendim-Erion-Pano.pdf>

8.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Nga hetimi i thellë administrativ i kryer, nuk u provua asnjë indicie apo element që cenon figurën e prokurorit Erion Pano dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “i aftë”. [...] Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.*

III. Shkaqet e ankimit

9. Komisionerja Publike Irena Nino, më datë 06.01.2023, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 592, datë 21.11.2022. Komisionerja Publike pretendon në ankim se nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla faktike e ligjore, për të cilat çmon se vendimi i Komisionit është i cenueshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Sipas Komisioneres Publike, bazuar në kërkesat e dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm nr. 84/2016, konstatohet se përfundimet e arritura nga Komisioni nuk kanë qenë të drejta dhe në pajtueshmëri me provat e administruara. Në vlerësimin e Komisioneres Publike, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.
10. Për rrjedhojë, Komisionerja Publike, bazuar në nenet Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi nga Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 592, datë 21.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
11. Referuar përmbajtjes së ankimit, rezulton se shkaqet e ngritura në ankim lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon.

Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

12. Komisionerja Publike ndan qëndrim të ndryshëm nga vlerësimi i situatës faktike të kryer nga Komisioni dhe përfundimet e arritura prej tij, sa i takon kriterit të vlerësimit të pasurisë, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Këtë shkak të ankimit, Komisionerja Publike e bazon në pretendimet si më poshtë vijnë.

12.1. Subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve gjatë viteve 2005-2007, të cilat janë investuar në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë, në shumën 1.235.663 lekë.

12.2. Subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për pagesën e këstit të parë të apartamentit me sipërfaqe 92,8 m², në Tiranë, në vitin 2010, si

rezultat i mosdeklarimit të posedimit në *cash* të shumës së pretenduar si burim prej 1.797.500 lekësh, e krijuar nga tërheqja nga llogaria bankare e bonove të thesarit në vitin 2008.

12.3. Pamjaftueshmëritë në burime të ligjshme, si më sipër evidentuar, duhet të vlerësohen së bashku edhe me diferencën negative prej të paktën (-) 361.551 lekësh, të konstatuar nga vetë Komisioni në analizën financiare të këtij të fundit për vitin 2016.

Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

13. Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2010⁴, procedimin penal nr. {***} të vitit 2018⁵ dhe procedimin penal nr. {***} të vitit 2018⁶, Komisionerja Publike Irena Nino ka pretenduar në ankim se, bazuar në indikatorët vlerësues të parashikuar nga nenet 71-73 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, janë konstatuar mangësi në kryerjen e veprimeve procedurale, të tilla që nuk pajtohen me pritshmërinë se prokurori duhet të udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë dhe i ndërmarrjes së hetimeve të shpejta dhe të plota, të gjithanshme dhe objektive, me qëllim arritjen e një përfundimi të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe prova.
14. Sipas Komisioneres Publike, mangësitë e konstatuara në këtë kriter vlerësimi, duhen vlerësuar së bashku dhe me problematikat e vërejtura në kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të cilat mund të çojnë në një vlerësim të ndryshëm nga ai i arritur nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

15. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisionerja Publike të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimitimi i ankuesit

16. Komisionerja Publike legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda

⁴ Me kallëzues shtetasin G. Sh.

⁵ Me kallëzues shtetasin S. Ç.

⁶ Me kallëzuese shtetasen A. S.

afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

17. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, që i përket shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 592, datë 21.11.2022, për subjektin e rivlerësimit Erion Pano, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.
18. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në seancë gjyqësore publike, Komisionerja Publike Irena Nino, pasi prezantoi pretendimet e saj lidhur me shkaqet e ankimit, me kërkesë të trupit gjykues, paraqiti edhe analizën financiare për vitet 2005-2007, e cila iu vu në dispozicion edhe subjektit të rivlerësimit për të dhënë qëndrimin e tij lidhur me të.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

19. Komisioni, në vendimin⁷ objekt kontrolli, lidhur me kriterin e pasurisë, ka arritur në konkluzionin se: *Nga një analizë logjike e të gjitha fakteve të rezultuara gjatë hetimit, trupi gjykues çmon se deklaratimet e subjektit përgjatë procesit të rivlerësimit të tij, gjejnë harmoni me situatën e pasqyruar në deklaratën “vetting”. Për rrjedhojë, Komisioni rishikoi analizën financiare duke marrë në konsideratë kursimet cash të saktësuara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe pas prapësimeve, analiza financiare mbi mundësitë e subjektit për blerjen e apartamentit për periudhën 2001-2011, referuar tabelës së përgjithshme, do të rezultonte me një balancë negative në shumën totale prej 117.163 lekësh, vetëm për vitin 2006.*
20. *Në përfundim, Komisioni, duke vlerësuar në tërësi çështjen dhe duke marrë në konsideratë arsyetimet sa më sipër, çmon se pamjaftueshmëria financiare e rezultuar nga analiza e kryer nga Komisioni është në një masë të tillë që nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra në bazë të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
21. Komisionerja Publike Irena Nino e ka kundërshtuar këtë konkluzion të Komisionit, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pamjaftueshmëri për të mbuluar me burime financiare të ligjshme kursimet dhe shpenzimet për periudhën 2005-2007, për një diferencë negative në shumën 1.235.663 lekë, periudhë gjatë së cilës janë krijuar investimet në bono thesari. Gjithashtu, Komisionerja Publike kundërshtoi edhe konkluzionin e Komisionit lidhur me vlerësimin e burimeve të ligjshme të pagesës së këstit të parë të apartamentit me sipërfaqe 92,8 m², në Tiranë, në vitin 2010, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për kryerjen e pagesës së këtij kësti, në shumën prej 1.797.500 lekësh, si pasojë e faktit të konstatuar gjatë hetimit administrativ, se vlerat monetare të investuara në bono thesari deri në vitin 2007 dhe të tërhequra nga llogaria bankare në vitin 2008, në shumën 1.900.000 lekë, të pretenduara si burim

⁷ Shih paragrafët 145 dhe 146 të vendimit të Komisionit nr. 592, datë 24.12.2022, faqet 29 dhe 30.

për pagesën e një pjese të kështit të parë të apartamentit, nuk ishin deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në asnjë prej deklarimeve periodike (për vitet 2008 dhe 2009) para ILDKPKI-së, në formën e kursimit gjendje *cash* në banesë.

22. Komisionerja Publike, gjatë gjykimit, ka pretenduar se nga analiza e akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, si dhe në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndan qëndrim të ndryshëm për vlerësimin e situatës faktike dhe përfundimet e arritura nga Komisioni, lidhur me burimet e krijimit të pasurisë apartament banimi. Në argumentimin e këtij qëndrimi, Komisionerja Publike ka parashtruar: *kur si burim për krijimin e një pasurie, deklarohen prej subjekteve të rivlerësimit kursime të poseduara në cash, nisur për nga natyra e tyre, Kolegji ka orientuar Komisionin t'i llogarisë këto kursime sikundër deklarohen në deklaratat periodike vjetore, të cilat në kuadër të këtij procesi, marrin vlerën e provës. Vlerësimi i Komisionit dhe rishikimi i analizës financiare, duke marrë në konsideratë kursimet cash të saktësuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në përgjigje të barrës së provës, duket se nuk mbështetet në praktikën e konsoliduar gjyqësore të Kolegjit. Për më tepër rezulton se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, gjatë procesit të hetimit administrativ, krahasuar me deklaratimet e dhëna në procesverbalet e mbajtura pranë ILDKPKI-së, mbi të cilat Komisioni ka bazuar dhe vendimmarrjen e tij, janë kontradiktore dhe të pasakta, duke e pamundësuar kështu gjurmimin dhe përlllogaritjen e tyre, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve të përdorura për pasurinë "apartament me sipërfaqe 92,8 m²".*
23. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi mori në shqyrtim këtë shkak të ankimit të Komisioneres Publike, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
24. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasuria objekt kontrolli është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si: *Apartament banimi 83 m² + (sip. përbashkët 9,8 m²), adresa "{****}", shk. {****}, ap. {****}, {****}, Tiranë, nr. regjistri hipotekor {****}, dt. 21.10.2011. Realizuar me kontratë shitblerje nr. {****} rep., nr. {****} kol., datë 05.10.2011, me palë shitëse {****} Konstruksion dhe blerës Erion Pano. Vlera e deklaruar e apartamentit është në shumën 61.000 euro, me pjesë takuese 50%. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të saj: (i) Huamarrje 3.000.000 (tre milionë) lekë, realizuar me kontratën e huamarrjes nr. {****} rep., nr. {****} kol., dt. 27.09.2011. Shuma e detyrimit financiar prej 3.000.000 lekësh, i është shlyer huadhënësit ndër vite dhe e plotë më datë 12.10.2016, si dhe evidentohet në deklaratën noteriale nr. {****} rep., dhe nr. {****} kol. (bashk. dokumentet). (ii) Kontratë huamarrje nr. {****} rep., dhe nr. {****} kol., datë 12.12.2008, në shumën 10.000 (dhjetë mijë) euro. Shuma e detyrimit financiar prej 10.000 (dhjetë mijë) eurosh i është shlyer huadhënësit ndër vite dhe e plotë më datë 12.12.2014, si dhe evidentohet në deklaratën noteriale nr. {****} rep., nr. {****} kol. (bashk. dokumentet). (iii) Shuma prej 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekësh e Bonove të Thesarit (në emër të Erion Pano) në Bankën e Shqipërisë, me burim kursimet e mia e të bashkëshortes nga puna ndër vite, të cilën e kam tërhequr të plotë në datën 19.06.2008. (iv) Shuma prej 848.947 (tetëqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë) lekësh bono thesari (në emër të E. P.) B.SH., me burim kursimet e mia e të bashkëshortes nga puna ndër vite, tërhequr datë 24.02.2011. (v) Interesat e Bonove të Thesarit, gjendja cash në banesë, akumuluar ndër vite nga pagat e mia e të bashkëshortes.*

25. Kjo pasuri rezulton se është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2010 si vijon: *Apartament banimi 92,8 m², adresa rruga “{***}”, kati {***}, nr. {***}, {***}, Tiranë. Kontratë porositëse për ndërtim dhe dorëzim apartamenti, me palë sipërmarrëse “{***}” dhe porositëse E. P., dt. 25.03.2010. Vlera në total 61.000 euro, me afat likuidimi 25.03.2012. Pagar 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro, pjesa 50%. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të saj: shuma e paguar, rezultat i të ardhurave nga pagat vjetore që prej fillimit të punës (deklaruesi dhe bashkëshortja), huamarrje dhe kredi. Në seksionin “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) Kontratë kredie dhe hipotekimi ProCredit Bank, katërqind mijë principal + interes 94.4000 lekë. Kësti mujor 16.700 lekë. Data e fillimit 10.11.2008, e mbarimit 10.06.2011. (ii) Kontratë huamarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2008, shuma 10.000 euro. Afati i shlyerjes: 12.12.2010. Shtyrë me marrëveshje mes palëve me afat përfundimtar shlyerje 12.09.2011. Huadhënësi A. V., President i universitetit {***}.*
26. Në vijim, në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2011, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi 83 m² (sip. e përbashkët 9,8 m²), adresa rruga “{***}”, kati {***}, {***}, Tiranë, nr. regjistri hipotekor {***}, datë 21.10.2011. Kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.10.2011, me palë shitëse “{***}” dhe blerës Erion Pano. Vlera në total 61.000 euro, e likuiduar plotësisht 05.10.2011. Pagar 36.000 (tridhjetë e gjatë mijë) euro. Pjesa: 50%. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të saj: Shuma e paguar, rezultat i të ardhurave nga pagat vjetore që prej fillimit të punës (deklaruesi dhe bashkëshortja), huamarrje, qiramarrje dhe kredi.*
27. Trupi gjykues vëren se Komisioni, në rezultatet përfundimtare të hetimit lidhur me apartamentin e sipërcituar, ka konstatuar se: (i) ka mospërputhje të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me kursimet cash në deklaratat periodike ndër vite, me shpjegimet e dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe me shpjegimet e dhëna në procesverbalet e mbajtura pranë ILDKPKI-së, nga analizimi i të cilave ka rezultuar një balancë negative për vitet 2009-2011, në vlerë totale 3.834.458 lekë; (ii) subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e bonove të thesarit dhe shtesën e likuiditeteve cash (nga tërheqja e bonove) në deklaratimet periodike ndër vite, të përdorura për blerjen e apartamentit në vitet 2010-2011; dhe (iii) duket se subjekti nuk ka pasur mundësi për blerjen e bonove të thesarit, duke rezultuar me një balancë negative në shumën totale 590.986 lekë, për vitet 2005-2006. Në lidhje me këto konstatime, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
28. Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve gjatë viteve 2005-2007, të cilat janë investuar në bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë, në shumën 1.235.663 lekë, trupi gjykues vëren se:
29. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me deklarimin e kursimeve në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë (në vijim “DIPPV”), të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

- Në DIPPV-2003, subjekti ka deklaruar: *bono thesari 500.000 lekë, Banka e Shtetit Shqiptar, burimi të ardhura nga paga dhe të dhuruara nga familja*. Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar kursime *cash*.
- Në DIPPV-2004, subjekti ka deklaruar vetëm të ardhurat nga pagat, si dhe interesat nga investimi në bono thesari, nuk ka deklaruar kursime *cash*.
- Në DIPPV-2005, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, subjekti ka deklaruar: *bono thesari, Banka e Shqipërisë, viti 2005, kursime familjare, shuma 300.000 lekë*. Në të njëjtën deklaratë, në seksionin “Të dhëna që nuk publikohen”, subjekti ka deklaruar: *400.000 lekë, kursime familjare nga pagat vjetore*.
- Në DIPPV-2006, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, subjekti ka deklaruar: (i) *kursime në para (nga paga) 700.000 lekë, pjesa takuese 60%*; (ii) *kursime nga paga për vitin 2005, të depozituara në bono thesari, Banka e Shqipërisë, shuma 400.000 lekë, pjesa takuese 60%*; (iii) *kursime nga paga, depozituar në bono thesari, Banka e Shqipërisë (bashkëshortja), shuma 300.000 lekë, pjesa takuese 40%*.
- Në DIPPV-2007, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, subjekti ka deklaruar: (i) *Erion Pano, kursime nga paga viti 2007, shuma 492.019 lekë, pjesa takuese 60%*; (ii) *E. P., kursime nga paga viti 2007, shuma 328.186 lekë, pjesa takuese 40%*; (iii) *blerje bono thesari, Banka e Shqipërisë, datë maturimi 19.6.2007, shuma 700.000 lekë*.
- Në DIPPV-2008, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, subjekti ka deklaruar: *Erion Pano, kursime nga paga viti 2008, shuma 450.000 lekë, pjesa takuese 60%*; (ii) *E. P., kursime nga paga vjetore 2008, shuma 350.000 lekë, pjesa takuese 40%*.
- Në DIPPV-2009, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, subjekti ka deklaruar: *Erion Pano, kursime nga paga viti 2009, shuma 400.000 lekë, pjesa takuese 50%*; (ii) *E. P., kursime nga pagat, shuma 400.000 lekë, pjesa takuese 50%*.
- Në DIPPV-2010, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, subjekti ka deklaruar: *Erion Pano, kursime nga paga viti 2010, shuma 320.000 lekë, pjesa takuese 50%*; (ii) *E. P., kursime nga paga vjetore 2010, shuma 320.000 lekë, pjesa takuese 50%*.

30. Trupi gjykues konstatoi gjithashtu se, lidhur me saktësimin e kursimeve *cash*, referuar deklarimeve në deklaratat periodike për periudhën 2005 – 2010, subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorin nr. 2 të Komisionit, si dhe në prapësimet e tij ndaj rezultateve të hetimit administrativ, ka dhënë këto shpjegime:

- Në DIPPV-2005, [...] kam deklaruar bono thesari në shumën 300.000 lekë, me burim kursime familjare dhe në rubrikën: “Të dhëna që nuk publikohen”, kam deklaruar 400.000 lekë, kursime familjare nga pagat vjetore. Me kursime familjare, kam pasur parasysh kursimet në

total, të cilat kanë qenë 300.000 lekë në bono thesari dhe afërsisht 100.000 lekë në llogarinë time në bankën “Raiffeisen”.

- Në DIPPV-2006, [...] kam deklaruar kursime në para nga paga 700.000 lekë, kursime nga paga të depozituara në bono thesari 400.000 lekë, kursime nga paga (bashkëshortja) depozituar në bono thesari, në shumën 300.000 lekë. Dhe në këtë vit, të gjitha kursimet tona të vitit janë depozituar në sistemin bankar. Gjendja cash “0” lekë.
- Në DIPPV-2007, [...] kam deklaruar kursime të miat nga paga, viti 2007, në shumën 492.019 lekë, kursime të bashkëshortes, në shumën 328.186 lekë, blerje bono thesari në shumën 700.000 lekë. Gjendja cash në këtë vit ka qenë afërsisht 120.000 lekë (492.019 lekë + 328.186 lekë - 700.000 lekë bono thesari).
- Në DIPPV-2008, [...] kam deklaruar kursime të miat dhe të bashkëshortes në shumën 450.000 lekë dhe 350.000 lekë. Pra, në total 800.000 lekë. Në këtë vit nuk kemi pasur shtesa në sistemin bankar. Kjo shumë i është shtuar gjendjes cash të vitit 2007. Pra, në total në vitin 2008, kemi pasur 920.000 lekë (120.000 lekë + 800.000 lekë) nga kursimet e vitit 2007 dhe 2008, si dhe 1.797.500 lekë tërhequr nga bonot e thesarit (pas kalimit në “Raiffeisen” Bank”, kjo shumë është tërhequr cash) dhe 10.000 euro të deklaruara në rubrikën: “Detyrimet financiare”, të marra hua nga z. A. V.
- Në DIPPV-2009, [...] kam deklaruar kursime nga paga, Erion Pano, viti 2009, vlerën 400.000 lekë, 50%, dhe kursime nga paga, E. P., 400.000 lekë, 50%. Në fund të vitit 2009, kemi pasur gjithsej në cash 1.320.000 lekë nga kursimet e viteve 2007, 2008 dhe 2009, si dhe 10.000 euro nga huaja dhe 1.797.500 lekë nga bonot e thesarit.
- Në DIPPV-2010, [...] deri në momentin e pagesës së këstit të apartamentit, në shumën 25.000 euro (mars 2010), kemi pasur nga kursimet cash të viteve 2007, 2008, 2009 shumën 1.320.000 lekë, shumën 10.000 euro të marrë hua dhe lekët e tërhequra cash nga bonot e thesarit, 1.797.500 lekë. Pas pagesës së këstit të apartamentit në shumën 25.000 euro, shuma e mbetur cash në fund të vitit 2010, ka qenë afërsisht 1.355.000 lekë.

31. Trupi gjykues vëren se referuar procesverbaleve të mbajtura nga ILDKPKI-ja në vitet 2009, 2013 dhe 2016, lidhur me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit pranë këtij institucioni, ka rezultuar se:

- Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 03.07.2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Për sa i takon gjendjes së llogarisë rrjedhëse të pagës mujore, në Raiffeisen Bank, nuk e kam deklaruar pasi kam deklaruar të ardhurat vjetore. [...] sqaroj se kam deklaruar gjendjen cash, për vitin 2007, pra në fund të vitit dhe diferencën e gjendjeve cash të deklaruara më parë e kam kaluar në bono thesari. Mosdeklarimi është çështje teknike, pasi nuk kam pasqyruar pakësimin e gjendjeve cash, por kam pasur mundësi kursimesh.*
- Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 14.02.2013, i pyetur se sa ka qenë gjendja e likuiditeteve në bono thesari dhe likuiditeteve në gjendje cash në datën 31.12.2011, subjekti ka deklaruar: *[...] gjendja më 31.12.2011 e Bonove të Thesarit në Bankën e Shqipërisë në emrin tim, është 0 lekë. Gjendja e likuiditeteve të kursyera nga puna ndër vite*

*në cash në datë 31.12.2011, është rreth 1.500.000 lekë pas pakësimit të shumës 1.600.000 lekë të cilën e përdora për likuidimin e detyrimit në vitin 2011 ndaj shoq. “{***}”.*

- Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 08.03.2016, i pyetur se sa ka qenë gjendja e likuiditetit *cash* në datën 31.12.2014, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se *një pjesë e gjendjeve cash të deklaruara nga ana ime në vitet 2005-2011 janë përdorur për shlyerjen e dy kësteve të apartamentit, si dhe për nevoja familjare. Gjendja cash në datë 31.12.2014, është afërsisht 1.100.000 lekë.*

32. Në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të Komisioneres Publike lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues çmon të marrë në analizë të hollësishme krijimin e kursimeve gjendje *cash*, të cilat kanë shërbyer si burim për investimin në bono thesari në periudhën 2005-2007. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerësoi të nevojshme analizimin nëpërmjet krahasimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit si më sipër referuar, lidhur me kursimet e deklaruara në deklaratat periodike vjetore për periudhën 2005-2007, deklarimeve të dhëna në procesverbalet e mbajtura pranë ILDKPKI-së, si dhe atyre gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, vlerësuar këto edhe në raport me dokumentacionin bankar të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision.
33. *Lidhur me gjendjen e likuiditeteve të deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2005 (pasqyrim i gjendjes së likuiditeteve në datën 31.12.2005), më konkretisht sa i takon: (i) deklarimit të subjektit të rivlerësimit në rubrikën “Ndryshimet e interesave private, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, sipas të cilit ai zotëronte bono thesari pranë Bankës së Shqipërisë, në shumën 300.000 lekë, me burim “kursime familjare”; dhe (ii) deklarimit të subjektit në rubrikën “Të dhëna që nuk publikohen”, të kursimeve familjare në shumën 400.000 lekë, me burim nga pagat vjetore, rezultoi se në shpjegimet e dhëna ndaj rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se me termin e përdorur, “kursime familjare”, ka pasur parasysh kursimet në total, të cilat kanë qenë 300.000 lekë në bono thesari dhe afërsisht 100.000 lekë në llogarinë e tij në Bankën Raiffeisen. Ndërkohë që, referuar procesverbalit të mbajtur nga ILDKPKI-ja më datë 03.07.2009, teksa është pyetur në lidhje me arsyen e mosdeklarimit të gjendjes së llogarisë bankare pranë Bankës Raiffeisen, prej 165.356 lekësh, në datën 31.12.2005, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, sa i takon gjendjes së llogarisë rrjedhëse të pagës mujore, në Bankën Raiffeisen, nuk e ka deklaruar atë pasi e ka vlerësuar si të mjaftueshëm deklarimin e të ardhurave vjetore.*
34. Trupi gjykues vëren se Komisionerja Publike në ankimin e saj dhe gjatë gjykimit, ka pretenduar se ndryshe nga sa ka saktësuar gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit, deklarimi prej tij i 400.000 lekëve kursime familjare, përbën një kursim jashtë sistemit bankar, të palidhur me kursimet që janë investuar në bono thesari në shumën 300.000 lekë, pranë Bankës së Shqipërisë, të cilat, referuar edhe analizës financiare të depozituar nga Komisionerja Publike gjatë gjykimit, rezultuan me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej 88.893 lekësh. Komisionerja Publike pretendoi gjithashtu se saktësimi i subjektit të rivlerësimit nuk përkon as me deklarimin e tij në DIPPV-2006, sipas të cilit ka deklaruar se kursimet nga pagat për vitin 2005, në shumën e 400.000 lekëve, janë investuar në bono thesari në Bankën e Shqipërisë në vitin 2006.

35. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet dhe diskutimet përfundimtare para Kolegjit, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikundër dhe në hetimin administrativ, duke pretenduar se gjendja e likuiditeteve është lehtësisht e gjurmueshme, pasi kursimet e tij dhe të bashkëshortes kanë qenë vetëm kursimet e depozituara në sistemin bankar. Sipas tij, në vitin 2005, subjekti i rivlerësimit dispononte shumën 800.000 lekë në bono thesari, nga të cilat 500.000 lekë ishin depozituar në vitin 2003 dhe 300.000 lekë në vitin 2005, si dhe rreth 100.000 lekë ishin gjendje në llogarinë pranë Bankës Raiffeisen.
36. Trupi gjykues, në vlerësim të sa më sipër konstatuar lidhur me gjendjen e likuiditeteve jashtë sistemit bankar në vitin 2005, gjen të drejtë dhe të bazuar pretendimin e Komisioneres Publike se ky kursim është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2005, në shumën e 400.000 lekëve. Këtë konkluzion, trupi gjykues e bazon në faktin se nga analizimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si më sipër evidentuar, rezultoi e provuar që deklaratimet lidhur me krijimin e likuiditeteve (kursime gjendje *cash*, bono thesari, gjendje në llogari bankare) kanë mospërputhje dhe, rrjedhimisht, konfirmojnë konkluzionin se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe gjatë gjykimit në Kolegj nuk arritën të shpjegojnë bindshëm versionin e tij lidhur me masën e kursimeve të deklaruara.
37. Konkretisht, u konstatua se nga dokumentacioni bankar, rezultoi se gjendja e llogarisë së subjektit të rivlerësimit më datë 31.12.2005, ishte më e lartë sesa vlera prej 100.000 lekësh e pretenduar nga subjekti në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, si pjesë e kursimit të deklaruar prej 400.000 lekësh nga pagat vjetore, fakt ky që, vlerësuar së bashku me deklaratimet e dhëna në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 03.07.2009, ku subjekti pohonte mosdeklarimin prej tij në deklaratën periodike të vitit 2005 të gjendjes së llogarisë rrjedhëse, bindi trupin gjykues se vlera e likuiditetit, gjendje në llogarinë bankare, në datën 31.12.2005, nuk ishte pjesë e kursimeve të deklaruara nga ana e subjektit në deklaratën periodike të atij viti. Mbi të gjitha, trupi gjykues i çmoi të pabesueshme sqarimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit për mënyrën e deklarimit të kursimeve në deklaratën periodike të vitit 2005, pasi konstatoi se ato ishin haptazi në kundërshtim me deklaratën periodike të vitit 2006, ku lidhur me investimin në bono thesari, në shumën e 400.000 lekëve gjatë këtij viti, subjekti kishte deklaruar si burim kursimet nga paga të vitit 2005, ndërkohë që sipas sqarimeve të tij gjatë procesit në Komision, kursimet e vitit 2005 kishin qenë vetëm ato të investuara në bono thesari në shumën prej 300.000 lekësh dhe gjendja në llogari bankare prej rreth 100.000 lekësh.
38. Në vijim të konkluzionit të mësipërm, në Kolegj u krye kontrolli i analizës financiare të Komisionit dhe asaj të paraqitur nga Komisionerja Publike në gjykim, nga ku rezultoi se për vitin 2005, subjekti dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 88.893 lekë, për të krijuar kursime dhe mbuluar shpenzimet e vitit 2005, rezultat ky i njëjtë me analizën financiare të Komisioneres Publike.
39. *Lidhur me gjendjen e likuiditeteve të deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2006* (pasqyrim i gjendjes së likuiditeteve në datën 31.12.2006), më konkretisht sa u takon: (i) kursimeve në para (nga paga) 700.000 lekë; (ii) kursimeve nga paga për vitin 2005, të depozituara në bono thesari, Banka e Shqipërisë, shuma 400.000 lekë; dhe (iii) kursimeve nga paga, depozituar në

bono thesari, Banka e Shqipërisë (bashkëshortja), shuma 300.000 lekë – rezulton se subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ në lidhje me deklaratën periodike të vitit 2006, ka sqaruar se *ka deklaruar kursime në para nga paga në shumën e 700.000 lekëve, kursime nga paga të depozituara në bono thesari në shumën 400.000 lekë dhe kursime nga paga (bashkëshortja), depozituar në bono thesari në shumën 300.000 lekë. Për këtë vit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se të gjitha kursimet e vitit i kanë depozituar në sistemin bankar dhe gjendja e likuiditetit cash jashtë sistemit bankar ka qenë “0” lekë.*

40. Komisionerja Publike në ankimin e saj dhe gjatë gjykimit, pretendoi se përkundër saktësisimit të bërë nga subjekti gjatë hetimit administrativ për kursimet e vitit 2006, nga deklarimi i tij në DIPPV-2006, rezulton se shuma prej 400.000 lekësh, e investuar në bono thesari në emër të subjektit gjatë këtij viti, ka pasur si burim kursimet e vitit të mëparshëm (viti 2005). Rrjedhimisht, në vlerësim të Komisioneres Publike, për vitin 2006, krahas kursimeve të evidentuara në llogarinë bankare, duhet të konsiderohet si kursim jashtë sistemit bankar edhe shuma prej 700.000 lekësh, sipas deklarimit të subjektit në DIPPV-2006. Për kursimin prej 700.000 lekësh jashtë sistemit bankar, Komisionerja Publike pretendoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 402.276 lekë.
41. Subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi këtë pretendim të Komisioneres Publike, duke argumentuar se në fund të vitit 2006, ai nuk ka pasur mundësi të krijojë kursime jashtë sistemit bankar, siç pretendohet nga Komisionerja Publike. Sipas subjektit të rivlerësimit, të gjitha kursimet vjetore kanë qenë të depozituara në sistemin bankar, ndërsa shuma prej 700.000 lekësh përfaqëson kursimet e investuara në bono thesari, duke theksuar se gjendja në *cash* për vitin 2006, ka qenë zero.
42. Trupi gjykues, në analizë të sa më sipër, vlerëson se saktësimet e bëra nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe gjatë gjykimit në Kolegj, bien ndesh me deklaratimet e bëra në DIPPV-2006, pasi si arsyetuar edhe më sipër, për shumën 400.000 lekë të deklaruar si të depozituar në bono thesari në emrin e tij, në vitin 2006, ka deklaruar si burim krijimi kursimet e vitit 2005, fakt ky që provon pretendimin e Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, në deklaratën periodike të vitit 2005, kanë deklaruar gjendje kursimi *cash* jashtë sistemit bankar në shumën prej 400.000 lekësh, të cilën e kanë përdorur në vitin në vijim, 2006, si burim për investimin në bono thesari, në të njëjtën shumë. Ky arsyetim bazohet edhe në faktin se nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në fashikullin e çështjes, u vërejt se investimi në bono thesari nga bashkëshortja e subjektit është kryer në muajin shkurt dhe investimi nga vetë subjekti në muajin qershor të vitit 2006 dhe jo në fund të këtij viti. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit, i pranuar edhe nga Komisioni, se bonot e thesarit të investuara në vitin 2006 u krijuan tërësisht nga kursimet e këtij viti, është pretendim i pabesueshëm, i cili vjen në kontradiktë të hapur me deklarimin e bërë nga vetë subjekti në deklaratën periodike të vitit 2006, e cila përbën provë në këtë proces, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, trupi gjykues gjen të drejtë dhe të bazuar pretendimin e Komisioneres Publike se “kursimi në para (nga paga)” në shumën prej 700.000 lekësh, i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2006, ishte likuiditet në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, dhe jo kursim gjendje në bankë në formën e bonove të thesarit.

43. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, në Kolegj u krye kontrolli i analizës financiare të Komisionit dhe asaj të paraqitur nga Komisionerja Publike në gjykim, nga ku rezultoi se për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 402.276 lekë, për të krijuar kursime dhe mbuluar shpenzimet e vitit 2006, rezultat ky i njëjtë me atë të pretenduar nga Komisionerja Publike.
44. Lidhur me gjendjen e likuiditeteve të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007 (pasqyrim i gjendjes së likuiditeteve në datën 31.12.2007), më konkretisht sa u takon: (i) kursimeve nga paga e subjektit të rivlerësimit për vitin 2007, në shumën 492.019 lekë; (ii) kursimeve nga paga e bashkëshortes së subjektit për vitin 2007, në shumën 328.186 lekë; dhe (iii) blerjes së bonove të thesarit pranë Bankës së Shqipërisë, më datë 19.6.2007, në shumën 700.000 lekë, Komisionerja Publike në ankim ka pretenduar se, nisur nga mënyra e deklarimit të kursimeve në vitet 2003-2006 dhe vitet 2008 e në vijim, gjendet i pambështetur dhe saktësimi i bërë nga subjekti gjatë hetimit administrativ për vitin 2007, i pranuar nga Komisioni. Sipas Komisioneres Publike, edhe për këtë vit, shumës së kursyer në llogaritë bankare (llogaritë e pagave dhe llogaritë pranë Bankës së Shqipërisë), duhet t'i shtohet edhe shuma prej 820.205 lekësh, e deklaruar si “kursime nga paga” nga subjekti dhe bashkëshortja e tij. Në përfundim, Komisionerja Publike ka vlerësuar se, në konsideratë të kursimeve jashtë sistemit bankar në shumën 820.205 lekë, diferenca negative rezulton të jetë në shumën (-) 744.494 lekë.
45. Subjekti i rivlerësimit, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si në hetimin administrativ në Komision dhe në parashtrimet e ngritura në Kolegj lidhur me kursimet e vitit 2007, kundërshtoi pretendimin e Komisioneres Publike se për vitin 2007, shuma 820.205 lekë përfaqëson kursimet jashtë sistemit bankar. Sipas subjektit, edhe për këtë vit, sikundër dhe në vitet e mëparshme, ka deklaruar shumatoren e kursimeve të familjes, të cilat kanë qenë në shumën 820.205 lekë, nga të cilat 700.000 lekë janë investuar në bono thesari dhe diferenca prej afërsisht 120.000 lekësh përfaqëson gjendjen *cash*.
46. Trupi gjykues, në vlerësim të pretendimit të ngritur nga Komisionerja Publike, konstaton se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me mënyrën e deklarimit të kursimeve për vitin 2007, nuk janë bindëse duke qenë se u konstatua se këto shpjegime bien ndesh me deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2009, në të cilin vihet re të ketë deklaruar: *[...] sqaroj se kam deklaruar gjendjen cash, për vitin 2007, pra në fund të vitit dhe diferencën e gjendjeve cash të deklaruar më parë e kam kaluar në bono thesari. Mosdeklarimi është çështje teknike, pasi nuk kam pasqyruar pakësimin e gjendjeve cash, por kam pasur mundësi kursimesh*. Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit, i pranuar edhe nga Komisioni, se shuma 820.205 lekë përfaqëson kursimet familjare në sistemin bankar dhe jashtë tij, në vlerësim të trupit gjykues, është i pabesueshëm, pasi referuar deklaratimeve të vetë subjektit në procesverbalin e sipërcituar, kursimi i deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2007, është kursim në gjendje *cash*, ndërkohë që investimet në bono thesari në këtë vit (në shumën 700.000 lekë), sipas deklarimit të subjektit në këtë procesverbal, janë kryer me kursimin gjendje *cash*, të deklaruar në deklaratën periodike pararendëse, e cila rezulton të jetë në të njëjtën shumë, prej 700.000 lekësh, me vlerën e bonove të thesarit. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e Komisioneres Publike

se për vitin 2007, krahas kursimeve të evidentuara në llogaritë bankare, duhet të konsiderohet si kursim gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, edhe shuma 820.205 lekë, e deklaruar në deklaratën periodike vjetore nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të (bashkëshortja).

47. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, në Kolegj u krye kontrolli i analizës financiare të Komisionit dhe asaj të paraqitur nga Komisionerja Publike në gjykim, nga ku rezultoi se për vitin 2007, subjekti dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 744.494 lekë, për të krijuar kursime dhe mbuluar shpenzimet e vitit 2007, rezultat ky i njëjtë me atë të pretenduar nga Komisionerja Publike.
48. Në përfundim të analizës së mësipërme, bazuar në konstatimin e situatës faktike se deklarinimet e subjektit të rivlerësimit mbi kursimet gjendje *cash*, në deklaratat periodike vjetore, në deklarinimet e tij të mbajtura në procesverbalet e dokumentuara pranë ILDKPKI-së ndër vite dhe në deklarinimet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ, kanë rezultuar kontradiktore, trupi gjykues gjen të drejtë dhe të bazuar pretendimin e Komisioneres Publike se deklarinimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, për sa i përket përcaktimit të kursimeve gjendje *cash*, duhet të merren në konsideratë dhe të përlllogariten sipas deklarinimeve në deklaratat periodike, të cilat në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, marrin në mënyrë të posaçme vlerë provuese në kuadër të këtij procesi. Dhe, për pasojë, këto deklarime duhet të lexohen sipas mënyrës së përcaktuar nga ligji nr. 9049/2003, në përcaktimin e detyrimit ligjor për deklarimin nga subjektet e tij të shtesave dhe pakësimeve të likuiditeteve në çdo formë qofshin ato, në datën 31 dhjetor të vitit deklarues⁸. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me justifikimin e mospërputhjeve të konstatuara si pasojë e një perceptimi të gabuar në lidhje me mënyrën e plotësimit të deklaratave u gjetën nga trupi gjykues jo vetëm të paprovuara, por edhe të pabesueshme, duke pasur parasysh profilin profesional të këtij subjekti deklarues në raport me njohuritë ligjore.
49. Pas shqyrtimit dhe kontrollit në Kolegj të analizës financiare të kryer nga Komisionerja Publike, trupi gjykues i gjeti të bazuara rezultatet e kësaj analize financiare lidhur me vlerësimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të për të krijuar kursime, mbuluar shpenzimet dhe për të investuar në bono thesari për periudhën 2005-2007, të cilat rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme në shumën e (-) 1.235.663 lekëve, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

⁸ Shih nenin 4, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet shprehimisht:

“1. Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë:

[...] d. vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”.

50. *Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për pagesën e kështit të parë të apartamentit me sipërfaqe 92,8 m², në Tiranë, në vitin 2010, si rezultat i mosdeklarimit të posedimit në cash të shumës së pretenduar si burim, prej 1.797.500 lekësh, e krijuar nga tërheqja nga llogaria bankare e bonove të thesarit në vitin 2008, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
51. Komisioni, në vendim, arriti në përfundimin se, ndonëse situata faktike nuk ishte deklaruar saktë nga subjekti i rivlerësimit në kuptim të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, hetimi i kryer nuk konstatoi që kjo pasaktësi në deklarimin e kursimeve *cash* të kishte shërbyer për fshehjen e veprimeve të subjektit lidhur me këtë pasuri apo për krijimin e ndonjë pasurie tjetër. Në këtë kontekst, Komisioni vlerësoi se pasaktësitë e konstatuara ishin të paqëllimshme dhe se deklaratimet e subjektit në deklaratën *vetting* ndihmonin në interpretimin e saktë të deklarimeve të tij ndër vite. Për rrjedhojë, Komisioni çmoi se këto pasaktësi nuk mund të përbënin shkak për deklarimin e pamjaftueshëm të pasurisë objekt kontrolli.
52. Komisionerja Publike e kundërshtoi si të pabazuar këtë konkluzion të Komisionit, duke ngritur pretendime në drejtim të saktësisë së deklarimit në deklaratat periodike vjetore të gjendjes *cash* të poseduar në fund të vitit 2008 dhe gjatë vitit 2009, me burim nga tërheqja e bonove të thesarit, konkretisht duke theksuar se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk kishte deklaruar në DIPPV-2008 tërheqjen dhe posedimin e shumës prej rreth 1.797.500 lekësh; (ii) nuk rezultonte të kishte saktësuar as në deklaratimet e mëvonshme, në deklaratat periodike të viteve 2009 dhe 2010, ekzistencën dhe përdorimin e kësaj shume si burim për blerjen e apartamentit, sikundër kishte bërë për shumën prej 10.000 eurosh, marrë hua nga shtetasi A. V., të cilën e kishte rideklaruar si një nga burimet e blerjes së pasurisë në DIPPV-2010; (iii) në DIPPV-2010, si një ndër burimet e blerjes së apartamentit të banimit, kishte deklaruar edhe “kredi”, e cila, referuar deklaratës vjetore DIPPV-2008 dhe deklarimit të subjektit gjatë hetimit administrativ, ka shërbyer për rinovimin e banesës dhe blerjen e pajisjeve shtëpiake për apartamentin që kishte në përdorim në kohën e marrjes së kredisë.
53. Komisionerja Publike, bazuar në këto konstatime dhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerëson se burimi i deklaruar në deklaratën *vetting*: *të ardhura nga bono thesari të tërhequra nga llogaria bankare në gusht 2008*, për sa kohë nuk është deklaruar posedimi i tyre në *cash* nga ana e subjektit në vitet 2008 - 2009, dhe as nuk është deklaruar saktësisht si një nga burimet e pagesës së kështit të parë të pasurisë apartament banimi në vitin 2010, nuk mund të konsiderohet në mesin e burimeve të ligjshme të krijimit të shumës 25.000 euro, paguar në muajin mars të këtij viti.
54. Në parashtrimet e tij para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit në Komision, kundërshtoi pretendimin e Komisioneres Publike në lidhje me bonot e thesarit të përdorura si burim për blerjen e apartamentit, duke argumentuar se shuma prej 1.797.500 lekësh ishte produkt i kursimeve familjare të grumbulluara ndër vite. Ai shpjegoi se mosparaqitja e kësaj shume si gjendje *cash* kishte ardhur si pasojë e faktit se kjo shumë ishte lehtësisht e verifikueshme nga sistemi bankar dhe se nuk e kishte perceptuar si të nevojshme

ta deklaronte, pasi tërheqja e saj nuk përbënte një ndryshim të vërtetë në pasuri, si rezultat i një të ardhure shtesë, por thjesht kishte ndryshuar vendi i ruajtjes së këtyre fondeve. Sa i përket mosdeklarimit të tërheqjes dhe posedimit të shumës 1.797.500 lekë nga bonot e thesarit, subjekti i rivlerësimit pretendon se këtë informacion e ka korrigjuar në dy procesverbalet e mbajtura nga ILDKPKI-ja në vitet 2013 dhe 2016.

55. Trupi gjykues, në vlerësim të pretendimeve të ngritura nga Komisionerja Publike, nga sa më sipër, analizoi deklaramet e subjektit në deklaratën *vetting*, në deklaratat periodike vjetore, në procesverbalet e depozituara në ILDKPKI në vitet 2013 dhe 2016, si dhe në ato gjatë hetimit administrativ në Komision, duke i krahasuar me njëra-tjetrën, nën optikën e legjislacionit të zbatueshëm.

55.1. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit për apartamentin objekt shqyrtimi, si burim krijimi, ka deklaruar këto të ardhura:

- i. 3.000.000 lekë huamarrje nga z. N. M., më datë 27.09.2011.
- ii. 10.000 euro huamarrje nga z. A. V., më datë 12.12.2008.
- iii. 1.900.000 lekë bono thesari (në emër të Erion Pano), tërhequr më datë 19.06.2008.
- iv. 848.947 lekë bono thesari (në emër të E. P.), tërhequr më datë 24.02.2011.
- v. Interesat e bonove të thesarit, gjendja *cash* në banesë, akumuluar ndër vite nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes.

55.2. Në DIPPV-2010, subjekti ka deklaruar shlyerjen e kështit të parë të apartamentit në shumën 25.000 euro, në datë 25.03.2010, me burim krijimi: (i) të ardhurat nga paga vjetore që prej fillimit të punës të subjektit dhe bashkëshortes; (ii) huamarrje; dhe (iii) kredi.

55.3. Në DIPPV-2011, subjekti ka deklaruar shlyerjen e kështit të dytë të apartamentit në shumën 36.000 euro, më datë 05.10.2011, me burim krijimi: (i) të ardhurat nga paga vjetore që prej fillimit të punës të subjektit dhe bashkëshortes; (ii) huamarrje; (iii) qiramarrje; (iv) kredi.

55.4. Në procesverbalin e datës 14.02.2013, të mbajtur nga ILDKPKI-ja, subjekti i rivlerësimit, për shlyerjen e kështit të parë, ka deklaruar se ka përdorur kursimet nga puna e tij ndër vite, dhe më konkretisht: [...] (i) tërhequr më datë 26.06.2008, shumën 1.900.000 lekë të Bonove të Thesarit, në Bankën e Shqipërisë, të cilën e kisha pasur gjendje dhe të deklaruar më 31.12.2007, me burim nga kursimet e mia ndër vite; (ii) si dhe huamarrjen në shumën 10.000 euro, të deklaruar në vitin 2008, ndaj shtetasit A. V., për të cilën disponoj dhe kontratën përkatëse të kësaj huamarrjeje [...]. Në po të njëjtin procesverbal, i pyetur në lidhje me mosdeklarimin e shumës 842.063 lekë në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes në ProCredit Bank, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] shuma 842.063 lekë është transferuar në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes nga llogaria e bonove të thesarit në emër të saj pranë Bankës së Shqipërisë. Kjo shumë është tërhequr pasi na ka shërbyer në vitin 2011 për kompletimin e apartamentit [...].

55.5. Në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, si burim për krijimin e kështit të parë të apartamentit, në shumën 25.000 euro, të paguar më 25.03.2010, subjekti ka deklaruar këto

burime: (i) huaja në shumën 10.000 euro marrë z. A. V.; dhe (ii) shuma 15.000 euro⁹ nga shuma prej 1.900.000 lekësh, tërhequr në datën 19.06.2008, e investuar në bono thesari, me burim kursimet nga puna e subjektit dhe bashkëshortes, prej vitit 2001 dhe deri në vitin 2007.

55.6. Trupi gjykues konstaton se, nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar tërheqjen e bonove të thesarit nga banka apo posedimin në vitet 2008-2009 të shumës 1.797.500 lekë si gjendje *cash* nga ky burim, sikundër nuk rezultoi ta ketë deklaruar këtë shumë monetare as në deklaratën periodike të vitit 2010, si një nga burimet e përdoruara për shlyerjen e kështit të parë më datë 25.03.2010, për blerjen e pasurisë apartament banimi në rrugën “{***}”, Tiranë. Deklarimi i shumës prej 1.797.500 lekësh, të tërhequr nga bonot e thesarit, si burim për likuidimin e kështit të parë për blerjen e apartamentit në Tiranë, është bërë për herë të parë në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2013. Në këtë procesverbal, subjekti ka deklaruar si burim për shlyerjen e kështit të parë vetëm shumën 1.797.500 lekë nga bonot e thesarit dhe huanë prej 10.000 eurosh nga z. A. V., pa përfshirë kredinë, ndryshe nga sa është deklaruar në DIPPV-të e viteve 2010 dhe 2011.

55.7. Përveç sa më sipër, trupi gjykues konstaton se në deklaratat periodike të viteve 2010-2011, subjekti i rivlerësimit, si një ndër burimet për blerjen e apartamentit, ka deklaruar dhe kredi, fakt i cili në deklaratën *vetting* nuk është deklaruar. E vetmja kredi e marrë rezulton të jetë shuma prej 400.000 lekësh në vitin 2008, për të cilën në DIPPV-2008, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ka deklaruar: *Rinovim banese (blerje pajisje shtëpiake), kredi bankare Banka Pro-CREDIT, 400.000 lekë principal + interes 94.400 lekë, kohëzgjatja 30 muaj dhe kështi mujor 16.700 lekë. Dt. e kredisë 10.12.2008 [...].* Kredia rezulton të jetë marrë në të njëjtën kohë kur subjekti pretendon se shumën prej 1.797.500 lekësh, të tërhequr nga bonot e thesarit, e ka poseduar gjendje *cash* në shtëpi dhe në po të njëjtin vit kur ai deklaroi se kishte marrë huanë prej 10.000 eurosh nga z. A. V., fakt që dëshmon se subjekti i rivlerësimit në atë periudhë ka pasur nevojë për fonde financiare, në kundërshtim me pretendimin e tij se dispononte gjendje në *cash* në atë kohë. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga ProCredit Bank nr. {***} prot., datë 24.07.2020, në kontratën e kredisë, datë 10.12.2008, destinacioni i përdorimit të kredisë është përcaktuar për: *Rikonstruksion/Rinovim i banesës aktuale – kredia do të përdoret nga kredimarrësi për të bërë rikonstruksionin/rinovim të banesës aktuale të ndodhur në adresën: TIRANË, BLLOKU {***}, PLL. I RI.*

55.8. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, ndërkohë që shumën prej 1.797.500 lekësh nuk e ka deklaruar as si gjendje *cash* për vitet 2008-2009 dhe as si burim për pagesën e kështit të parë për apartamentin në Tiranë në vitin 2010, ndryshe ka vepruar me shumën prej 10.000 eurosh të marrë hua nga z. A. V., të cilën e ka deklaruar në momentin kur është marrë nga subjekti, në vitin 2008, dhe rideklaruar në vitin 2010, si burim për blerjen e pasurisë apartament banimi. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i shumës së mësipërme as si likuiditet gjendje *cash* dhe as si burim i krijimit të pasurisë objekt kontrolli në deklaratat periodike nga subjekti i rivlerësimit, si e vetmja mënyrë ligjore për të provuar ekzistencën dhe përdorimin e kësaj shume për qëllimin e pretenduar, e bëjnë të pabesueshëm pretendimin e subjektit mbi ekzistencën e këtij burimi, të deklaruar si të tillë për herë të parë

⁹ E konvertuar me kursin mesatar të muajit gusht të vitit 2008, 1 euro = 122 lekë.

në vitin 2013, pas kontrollit të kryer nga ILDKPI-ja, dhe në vijim edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Nevoja e subjektit të rivlerësimit për fonde monetare shtesë, e cila provohet me marrjen prej tij të kredisë dhe huasë në vitin 2008, në vlerësim të trupit gjykues e bën të pabesueshëm pretendimin e tij për disponim të gjendjes *cash* në fund të vitit 2008 dhe të papërdour deri në vitin 2010, kur është kryer pagesa e këstit të parë të apartamentit.

55.9. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se për shkak të mosdeklarimit të kësaj vlere monetare as si gjendje *cash* dhe as si burim për krijimin e pasurisë në deklaratat periodike përkatëse, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara nga ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, nuk u arrit të provohet se kjo shumë ka shërbyer si burim financiar i ligjshëm për pagesën e një pjese të këstit të parë prej 25.000 eurosh për blerjen e apartamentit objekt kontrolli. Për pasojë, pretendimi i Komisioneres Publike për mungesën e burimeve të ligjshme për kryerjen e pagesës së këstit të parë, në shumën e 1.797.500 lekëve, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, u gjeti i bazuar në fakte dhe në ligj.

55.10. Në përfundim, trupi gjykues e gjeti të bazuar shkakun e ankimit të Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimet e ligjshme për krijimin e kursimeve të deklaruara në vitet 2005-2007, për një diferencë negative në shumën (-) 1.235.663 lekë; (ii) rezultoi me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për pagesën e një pjese të këstit të parë të blerjes së apartamentit, në shumën 1.797.500 lekë; si dhe (iii) së bashku me diferencën negative prej të paktën (-) 361.551 lekësh, të konstatuar nga Komisioni për vitin 2016 – ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

II. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

56. Komisionerja Publike ka pretenduar në ankim lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale se për subjektin e rivlerësimit, bazuar në indikatorët vlerësues të parashikuar nga nenet 71-73 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, konstatohen disa raste me mangësi, të tilla që nuk pajtohen me pritshmërinë se prokurori duhet të udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë dhe ndërmarrjes së hetimeve të shpejta dhe të plota, të gjithanshme dhe objektive, me qëllim arritjen e një përfundimi të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe në prova.
57. Komisionerja Publike pretendon se përfundimi i Komisionit lidhur me këtë kriter, se: *subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme*, është rrjedhojë e një vlerësimi jo tërësor të fakteve dhe rrethanave të dala nga vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale. Sipas Komisioneres Publike, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës të dy prej denoncimeve të paraqitura në Komision (të shtetasve S. Ç. dhe A. S.) dhe të një çështjeje të dalë nga të dhënat e burimeve arkivore (kallëzim i shtetasit G. Sh.), duke u konstatuar për pasojë mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit lidhur me aspektin e njohurive dhe arsyetimit ligjor që konsistojnë në

marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, apo aftësinë e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetime.

58. Këto mangësi të konstatuara gjatë vlerësimit të këtij kriteri, referuar ankimit të Komisioneres Publike, duhen vlerësuar së bashku me problematikat e vërejtura në kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të cilat mund të çojnë në një vlerësim të ndryshëm me atë të arritur nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.
59. Ky shkak i ankimit të Komisioneres Publike është mbështetur në pretendimet konkrete lidhur me tri çështje të analizuara nga ana e Komisionit, si trajtuar në vijim.

*59.1. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, me kallëzues shtetasin G. Sh.:*

59.1.1. Lidhur me këtë procedim penal, Komisioni, pasi ka shqyrtuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimet në “Rezultatet e hetimit administrativ”, i ka vlerësuar bindëse ato, pasi nga analiza e situatës faktike, ka rezultuar se çështja penale objekt vlerësimi nuk ka marrë zgjidhje të shpejtë, jo për shkak të një hetimi të mangët nga ana e subjektit të rivlerësimit, por për shkak të rrethanave të tilla, të cilat objektivisht kanë penguar kryerjen e veprimeve të caktuara hetimore të urdhëruara nga gjykata. Përfundimisht, Komisioni ka vlerësuar se në tërësi nuk ka pasur fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

59.1.2. Në kundërshtim me sa konkluduar nga Komisioni, Komisionerja Publike Irena Nino në ankimin e saj, si dhe në parashtrimet e paraqitura në seancën publike të datës 07.03.2024, ka pretenduar se hetimet procedurale të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, kanë qenë të mangëta dhe jo të gjithanshme, konfirmuar kjo dhe nga vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë gjatë fazës së hetimeve paraprake, të cilat i kanë caktuar detyra konkrete subjektit të rivlerësimit për të arritur në një përfundim të drejtë për ecurinë e procedimit penal. Sipas Komisioneres Publike, referuar fakteve dhe rrethanave të marra në vlerësim, vonesat e konstatuara në ndërmarrjen e hetimeve logjike dhe efektive, janë konsideruar si të pajustificueshme. Konkretisht, në të dyja rastet e marrjes së vendimit të pushimit të procedimit penal nga ana e subjektit të rivlerësimit, gjatë periudhës së muajve shkurt - korrik të vitit 2010 e më pas, tetor 2011 - dhjetor 2012, megjithëse ka pasur detyra të qarta dhe konkrete të lëna nga gjykata në funksion të këtij procedimi, ato rezultojnë të papërmbyshura nga subjekti i rivlerësimit.

59.2. Lidhur me denoncimin e z. S. Ç.:

59.2.1. Komisionerja Publike Irena Nino ka kundërshtuar në ankimin e saj vlerësimin e Komisionit lidhur me denoncimin e ngritur nga S. Ç., se problematikat e konstatuara lidhur me procedimin penal nr. {***}, çmohen të pamjaftueshme për ta konsideruar subjektin me aftësi profesionale nën nivelin minimal të kërkuar nga germa “c” e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Sipas Komisioneres Publike, konkluzionet e Komisionit pas shqyrtimit të këtij denoncimi se: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar urdhërimet e gjykatës e cila në zbatim të nenit 329/3/b të Kodit të Procedurës Penale, ka çmuar se hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit kanë

qenë të paplota, duke përcaktuar edhe drejtimit e thellimit të hetimit, si dhe veprimet që duhet të kryheshin prej tij lidhur me çështjen; dhe se (ii) argumentet e subjektit për moskryerje të veprimeve hetimore, bazuar në bindjen e tij të brendshme dhe në justifikimin se kryerja e tyre nuk do të sillte asnjë risi për çështjen, nuk qëndrojnë, paragjykojnë hetimin e çështjes, si dhe vlerësimin e saj në përputhje me faktet dhe provat – çmohet se konfirmojnë mangësi të subjektit të rivlerësimit në drejtim të ndërmarrjes së hetimeve logjike e efektive dhe në respektim të urdhërimeve të lëna nga gjykata, mangësi këto të cilat konstatohen si të përsëritura. Për rrjedhojë, Komisionerja Publike pretendon se këto mangësi duhet të vlerësohen në raport me dispozitat ligjore që gjejnë zbatim për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, sipas parashikimeve të neneve 71-73 të ligjit nr. 96/2016.

59.3. Lidhur me denoncimin e znj. A. S.:

59.3.1. Komisionerja Publike Irena Nino ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit lidhur me vlerësimin e denoncimit të shtetas A. S., se subjekti i rivlerësimit lidhur me faktin e bashkimit të procedimeve penale është gjendur para kriterëve ndaluese procedurale, ku nuk mund të kryheshin hetime paralele, bazuar në nenet 29 dhe 79 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas Komisioneres Publike, mosfillimi i procedimit penal nga ana e subjektit të rivlerësimit, vlerësohet i pajustificueshëm, pasi referuar fakteve dhe rrethanave të marra në vlerësim, procedimi penal nuk dukej kompleks. Sipas Komisioneres Publike, në këtë rast janë konstatuar mangësi të ndërmarrjes së hetimeve logjike dhe mungesës së efektivitetit në zgjidhjen e rastit, për rrjedhojë, bazuar në indikatorët vlerësues të parashikuar në nenet 71-73 të ligjit nr. 96/2016, këto mangësi janë të tilla që nuk pajtohen me pritshmërinë se prokurori duhet të udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë dhe ndërmarrjes së hetimeve të shpejta dhe të plota, të gjithanshme dhe objektive, me qëllim arritjen e një përfundimi të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe në prova.

59.3.2. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi si të pabazuar në fakte dhe në ligj shkakun e ngritur nga Komisionerja Publike lidhur me vlerësimin nga Komisioni të kriterit të aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit, në vijim të qëndrimit të mbajtur gjatë hetimit në Komision, rikonfirmoi para Kolegjit se lidhur me tri procedimet penale të marra në shqyrtim si më sipër, ka arritur të kryejë veprime të mjaftueshme hetimore për të krijuar bindjen e tij, në kohë faktike të arsyeshme, pa shkaktuar zvarritje, duke bërë arsyetim koherent dhe evidentim të dispozitës procedurale korrekte, të cilat janë pranuar nga gjykatat.

60. Gjatë fazës së bisedimeve përfundimtare, në seancën publike të datës 04.04.2024, Komisionerja Publike Irena Nino, në përfundim të debatit gjyqësor, deklaroi se për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, i qëndron shkakut të ankimit lidhur me tri çështjet e evidentuara më sipër, procedimin penal nr. {***} me kallëzues G. Sh., procedimin penal nr. {***} me kallëzues S. Ç., si dhe procedimin penal nr. {***} me kallëzues A. S., për të cilat, sipas saj, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime hetimore të caktuara në përmbushje të ushtrimit të ndjekjes penale dhe janë evidentuar të meta dhe mangësi, të cilat të vetme nuk mund të shërbejnë si bazë për aplikimin e masës së parashikuar në nenin 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
61. Trupi gjykues vëren se Komisionerja Publike, ndryshe nga kërkimi fillestar i paraqitur në ankim dhe gjatë parashkrimeve në seancën gjyqësore të datës 07.03.2024, për vlerësimin e

këtyre mangësive të pretenduara, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, së bashku me problematikat e vërejtura nga kriteri i vlerësimit të pasurisë, duket se në përfundim të gjyqimit të çështjes në Kolegj, ndonëse u qëndron problematikave të pretenduara, nuk duket t'u atribuojë atyre pasoja ligjore qoftë në drejtim të cenimit të vlerësimit të Komisionit lidhur me kriterin e aftësive profesionale në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, qoftë në drejtim të cenimit të besimit të publikut, referuar parashikimeve të nenit 61, pika 5 e të njëjtit ligj. Ndodhur në këto kushte, trupi gjykues çmoi të panevojshëm analizimin e pretendimeve të Komisioneres Publike lidhur me problematikat e pretenduara në shkakun e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

62. Në përfundim të gjyqimit të çështjes, bazuar në analizën e mësipërme të situatës faktike dhe ligjore, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, ankimi i Komisioneres Publike lidhur me këtë kriter të rivlerësimit, u gjet i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe në ligj. Për pasojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 592, datë 21.11.2022, duhet të ndryshohet, duke i dhënë subjektit të rivlerësimit masën disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në germën “b” të pikës 1 të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 592, datë 24.11.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Erion Pano.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.04.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi – kundër

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi – kundër

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret Mimoza Tasi (në cilësinë e relatores së çështjes) dhe Albana Shtylla, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, kemi votuar kundër kërimit të ankimit të Komisionerit Publik dhe vendimit nr. 14, datë 15.4.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), që ka vendosur ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Si relatore, kam propozuar lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 592, datë 24.11.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Erion Pano.
2. Në vlerësimin tonë, subjekti i rivlerësimit është i besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe, për pasojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), duhet të ishte lënë në fuqi. Në vijim, paraqesim arsyetimin dhe argumentet, mbi të cilat mbështetet qëndrimi ynë.
3. Komisioni ka konstatuar se *subjekti i rivlerësimit Erion Pano ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë*, bazuar në nenet 58, pika 1, germa “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer deklarime të sakta në deklaratën *vetting* dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore, nuk rezultuan të kenë qenë të qëllimshme apo të kenë pasur si synim fshehje të pasurive apo deklarime të rreme. Në vlerësimin tonë, subjekti ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe nuk ka cenuar besimin e publikut të drejtësia.
4. Vendimi i Komisionit bazohet në analizën e burimeve të ligjshme, deklaratimet e subjektit sipas deklaratave periodike vjetore (në vijim “DPV”) dhe në deklaratën *vetting* për krijimin e një apartamenti në Tiranë. Nga hetimi administrativ i thelluar, ka rezultuar se çdo deklarim pas deklaratës *vetting* ka qenë në koherencë të plotë dhe në vijueshmëri të deklaratimeve të bëra që nga viti 2005, kur subjekti ka filluar të ushtrojë detyrën e prokurorit.
5. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasurinë e paluajtshme apartament me sipërfaqe 92,8 m², i ndodhur në Tiranë, në rrugën “{***}”, {***}, i cili është blerë me kontratën e shitblerjes, datë 05.10.2011, me çmim 61.000 euro. Burimet që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, janë: hua në shumën 3.000.000 lekë¹⁰, hua në shumën 10.000 euro¹¹, bono thesari në shumën 1.900.000 lekë¹², bono thesari në shumën 848.947 lekë¹³, interesat e bonove të thesarit dhe gjendja *cash* në banesë, akumuluar ndër vite nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes.
6. Referuar kësteve të pagesës për apartamentin, deklarimi për burimin e të ardhurave ka qenë:

¹⁰ Sipas kontratës së huamarrjes, datë 27.09.2011.

¹¹ Sipas kontratës së huamarrjes, datë 12.12.2008,

¹² Depozituar në emër të subjektit në Bankën e Shqipërisë, me burim kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes nga puna e tyre ndër vite, shumë e cila është tërhequr e plotë në datën 19.06.2008.

¹³ Depozituar në emër të bashkëshortes së subjektit në Bankën e Shqipërisë, me burim kursimet e të dy bashkëshortëve, shumë e cila është tërhequr në datën 24.02.2011.

- Për këstin e parë të pagesës, në shumën 25.000 euro, paguar në datën 25.03.2010, janë përdorur:

- (i) hua në shumën 10.000 euro, marrë nga shtetasi A. V.;
- (ii) shuma prej 15.000 eurosh, nga paratë e tërhequra në datën 19.06.2008, të cilat ishin investuar në bono thesari, në vlerën 1.900.000¹⁴ lekë, me burim kursimet nga të ardhurat nga puna e subjektit dhe bashkëshortes, gjatë viteve 2001– 2007.

- Për këstin e dytë të pagesës¹⁵, në shumën 36.000 euro, paguar në datën 05.10.2011, janë përdorur:

- (i) hua në shumën 3.000.000 lekë, marrë nga shtetasi N.M.;
- (ii) shuma prej 842.063 lekësh (bono thesari në emër të bashkëshortes), me burim kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes nga të ardhurat nga puna për periudhën 2001 – 2010;
- (iii) diferenca prej 9.000¹⁶ eurosh, me burim një pjesë të kursimeve *cash*, të kursyera nga të ardhurat nga puna e subjektit dhe bashkëshortes, për periudhën 2001 – 2011.

7. Vendimi i shumicës së trupit gjykues është bazuar në shkaqet e ankimit të ngritura nga Komisionerja Publike, referuar pamjaftueshmërisë së subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime financiare të ligjshme kursimet dhe shpenzimet për periudhën 2005 – 2007, për një diferencë negative në shumën 1.235.663 lekë. Gjithashtu, Komisionerja Publike kundërshtoi edhe konkluzionin e Komisionit lidhur me vlerësimin e burimeve të ligjshme të pagesës së kështit të parë të apartamentit me sipërfaqe 92,8 m², në Tiranë, në vitin 2010, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për kryerjen e pagesës së këtij kësti në shumën prej 1.797.500 lekësh, si pasojë e faktit të konstatuar gjatë hetimit administrativ se vlerat monetare të investuara në bono thesari deri në vitin 2007 dhe të tërhequra nga llogaria bankare në vitin 2008, në shumën 1.900.000 lekë, të pretenduara si burim për pagesën e një pjese të kështit të parë të apartamentit, nuk ishin deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në asnjë prej DPV-ve (për vitet 2008 dhe 2009) në formën e kursimit gjendje *cash* në banesë.

8. Nga sa më sipër, Komisionerja Publike ka ngritur si shkak ankimi mundësinë e subjektit për të krijuar këstin e parë të blerjes së apartamentit:

- vetëm për shumën prej 15 mijë eurosh, e cila përbëhet nga shuma e bonove të thesarit, në vlerën prej 1,9 milionë lekësh, tërhequr nga banka në qershor të vitit 2008;
- për arsye se vlera e bonove të thesarit në shumën prej 1,9 milionë lekësh nuk është deklaruar si kursim *cash* në banesë në DPV-të e viteve 2008 dhe 2009, pra jo për arsye të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj.

Në vlerësimin tonë, ankimi i Komisioneres Publike dhe vendimi i shumicës së trupit gjykues të Kolegjit janë të pabazuar, si dhe vijnë ndesh me parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit, në një vlerësim tërësor të kriterit të pasurisë, por edhe të tri kriterëve të rivlerësimit, duke ndëshkuar padrejtësisht subjektin e rivlerësimit. Për këtë arsye, kemi pasur

¹⁴ Konvertuar sipas kursit të këmbimit (gusht 2008) – 122 lekë.

¹⁵ Për këtë këst, nuk është ngritur shkak ankimi nga Komisionerja Publike.

¹⁶ Konvertuar sipas kursit të kohës, në rreth 1.250.000 lekë.

një qëndrim të ndryshëm për ankimin e Komisioneres Publike, bazuar në një vlerësim harmonik të provave të administruara, si dhe në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, duke konkluduar se subjekti e kalon testin e nivelit të besueshëm të kriterit të pasurisë e, për pasojë, vendimi i Komisionit duhej të lihej në fuqi.

Lidhur me diferencën negative në shumën 1.235.663 lekë, gjatë viteve 2005-2007

9. Fillimisht theksojmë se qëndrimi lidhur me këtë shkak ankimi, është i ndryshëm nga shumica vetëm për gjyqtaren Mimoza Tasi, ndërkohë që gjyqtarja Albana Shtylla ka mbajtur qëndrim të njëjtë si shumica lidhur me analizën e deklarimeve të subjektit për gjendjen e likuiditeteve/kursimeve në periudhën 2005-2007, duke konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet gjatë kësaj periudhe, në shumën prej 1.235.663 lekësh.

9.1. Unë, gjyqtarja Mimoza Tasi, lidhur me këtë shkak ankimi, në një vlerësim harmonik të fakteve dhe provave, kam arritur në një përfundim të ndryshëm nga ai i shumicës, sa i përket diferencës negative prej 1.235.663 lekësh për vitet 2005, 2006, 2007, duke e konsideruar atë një vlerë që i është shtuar si artificë subjektit të rivlerësimit, pa një lidhje logjike të analizës së fakteve, si dhe deklarimeve të tij në DPV-të e këtyre viteve. Ky qëndrim do të trajtohet në vijim në paragrafët 10 deri 20 të këtij mendimi pakice.

10. Në funksion të vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të përdorura për shpenzimet, investimet, përfshirë edhe për pasurinë apartament me sipërfaqe 92,8 m², u verifikuan dhe kontrolluan me detaje deklaratimet e subjektit në DPV-të e viteve 2005, 2006, 2007, të cilat përbëjnë provë në këtë proces, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Nga verifikimi i bërë, u konstatua se subjekti, në secilën prej DPV-ve ka deklaruar saktë, sipas mënyrës që ai e ka konceptuar deklarinë e tij, kursimet familjare në total, duke mos i diferencuar ato në kursime “gjendje cash” apo në “sistemin bankar”.

11. Në DPV-në e vitit 2005, nga subjekti janë deklaruar bono thesari në shumën 300.000 lekë, me burim kursime familjare. Ndërsa në seksionin “Të dhëna që nuk publikohen”, janë deklaruar 400.000 lekë kursime familjare nga pagat vjetore. Në konceptin “kursime familjare”, subjekti ka deklaruar në total kursimet, që janë në vlerën 400.000 lekë. Kjo vlerë ka qenë e depozituar në sistemin bankar, ku janë përkatësisht 300.000 lekë në bono thesari dhe afërsisht 100.000 lekë në llogarinë e tij në Bankën Raiffeisen¹⁷. Ky fakt rezulton i provuar nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në fashikullin e çështjes.

11.1. Në vlerësimin tim, gjendja e likuiditeteve/kursimeve në fund të vitit 2005, mund të gjurmohej lehtësisht, pasi kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes janë vetëm kursimet e depozituara në sistemin bankar. Konkretisht, në vitin 2005, në sistemin bankar gjendej vlera prej 800.000 lekësh në bono thesari, ku 500.000 lekë janë depozituar në vitin 2003, duke i shtuar edhe 300.000 lekë depozituar në vitin 2005, dhe rreth 100.000 lekë në llogarinë e tij në Bankën Raiffeisen. Pra, në fund të vitit 2005, subjekti ka pasur gjendje totale të likuiditeteve/kursimeve në shumën prej 1.130.303 lekësh, shumë kjo që ishte e depozituar në

¹⁷ Gjendja e llogarisë, Banka Raiffeisen, për vitin 2005.

sistemin bankar dhe gjendje në fund të vitit. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka deklaruar qartazi se nuk ka disponuar e pasur mundësi të ketë gjendje *cash* në shtëpi – jashtë sistemit bankar.

11.2. Vlerësimi i bërë nga shumica se gjendja e likuiditeteve në fund të vitit 2005, është shuma që gjendet në sistemin bankar plus kursimet *cash* të vitit 2005, është tërësisht i pabazuar. Në asnjë nga rubrikat e DPV-2005, subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të shprehur gjendje/kursime *cash* dhe as nuk ka lënë të nënkuptohet se ka disponuar dhe pasur mundësi që gjatë vitit 2005, të krijojë kursime jashtë sistemit bankar, ashtu si konkludohet nga shumica.

11.3. Bazuar në të dhënat lehtësisht të verifikueshme, si deklaramet e subjektit në DPV-2005, të ardhurat nga paga dhe kursimet në sistemin bankar, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit për vitin 2005, rezultoi se analiza e këtij viti nuk ka balancë negative në shumën (-) 88.893 lekë, por ka një tepriçë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (+) 311.107 lekë.

12. Në DPV-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar: “kursime në para (nga paga)”, në shumën 700.000 lekë; “kursime nga paga për vitin 2005, të depozituara në bono thesari, Banka e Shqipërisë”, në shumën 400.000 lekë; “kursime nga paga, depozituar në bono thesari, Banka e Shqipërisë (bashkëshortja)”, shuma 300.000 lekë. Në vlerësim të deklarameteve të sipërcituara të subjektit, është konsideruar se në seksionin e deklarimit të pasurive të luajtshme të DPV-së, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se gjatë vitit 2006 ka kursyer 700.000 lekë, të cilat kanë pasur si burim të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes nga paga. Në vlerësimin tonë, subjekti në po të njëjtin seksion, në rubrikat në vijim, ka detajuar se ku gjendej kjo shumë, duke evidentuar shprehimisht se ato janë depozituar: 400.000 lekë në bono thesari në Bankën e Shqipërisë në llogarinë e tij, si dhe 300.000 lekë po në bono thesari pranë kësaj banke në llogarinë e bashkëshortes.

12.1. Bazuar në këtë mënyrë të leximit të DPV-2006, kemi vlerësuar se edhe për vitin 2006, të gjitha kursimet vjetore të subjektit dhe bashkëshortes janë depozituar në sistemin bankar në shumën 700.000 lekë. Kjo vlerë mund të provohet lehtësisht nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në fashikullin e çështjes, pasi figuron si depozitë brenda sistemit bankar, e ndarë në llogaritë e dy bashkëshortëve.

12.2. Vlerësimi i shumicës në vendim, se në fund të vitit 2006, shuma 700.000 lekë është kursim jashtë sistemit bankar, nuk qëndron dhe është i pabazuar në faktet e deklaruara nga subjekti në DPV-2006. Në vijim, shumica arsyeton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, në DPV-2005 kanë deklaruar gjendje kursimi *cash* jashtë sistemit bankar në shumën prej 400.000 lekësh, të cilin e kanë përdorur në vijim në vitin 2006. Vlera prej 400.000 lekësh, e deklaruar si “kursime familjare”, e cila është e depozituar në sistemin bankar, nuk më rezulton të jetë deklaruar në mënyrë të shprehur si gjendje *cash*. Pra, nuk ka asnjë element kontradiktor mes deklarimit të bërë nga vetë subjekti në DPV-të e viteve 2005 dhe 2006, pasi në asnjë rubrikë të këtyre deklaratave nuk shprehet dhe as nuk nënkuptohet që subjekti ka gjendje *cash* të mbartur nga njëri vit në tjetrin.

12.3. Shumica shpreh se “kursimi në para (nga paga)”, në shumën prej 700.000 lekësh, i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DPV-në e vitit 2006, ishte likuiditet në gjendje *cash*

jashtë sistemit bankar dhe jo kursim gjendje në bankë në formën e bonove të thesarit. Në vlerësimin tim, “kursimi në para (nga paga)” në asnjë rast nuk mund të nënkuptojë likuiditet në gjendje *cash*, aq më tepër kur kjo shumë provohet se është investuar në bono thesari nga kursimet e vitit 2006 dhe përgjatë këtij viti kalendarik.

12.4. Në vlerësimin tim, gjatë vitit 2006, as në rubrikat e DPV-së dhe as gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti nuk ka deklaruar dhe nuk mund të nënkuptohet se ka pasur kursime jashtë sistemit bankar, sikundër arsyetohet nga shumica. Ai ka deklaruar kursime prej 700.000 lekësh në bono thesari, ndërsa jashtë sistemit bankar nuk ka pasur gjendje. Në konsideratë të këtij fakti, balanca negative për vitin 2006 rezulton të jetë (-) 102.276 lekë, e cila, ashtu si Komisioni, nuk vlerësohet me peshë domethënëse.

13. Në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar kursimet e tij nga paga në shumën 492.019 lekë, kursime nga paga të bashkëshortes në shumën 328.186 lekë, si dhe blerje bonosh thesari në shumën 700.000 lekë.

13.1. Subjekti, ashtu si në dy vitet e mëparshme (2005 dhe 2006), edhe në DPV-2007, ka deklaruar totalin e kursimeve të familjes, që ka qenë në shumën 820.205 lekë, nga të cilat 700.000 lekë u investuan në blerje bonosh thesari. Pra, subjekti ka disponuar gjendje *cash* në vitin 2007, afërsisht 120.000 lekë (492.019 lekë + 328.186 lekë; 700.000 lekë bono thesari).

13.2. Arsyetimi i shumicës se për vitin 2007, subjekti ka paraqitur si kursim jashtë sistemit bankar, vlerën 820.205 lekë, nuk qëndron, pasi kjo vlerë në DPV-2007, është totali i kursimeve për atë vit kalendarik. Subjekti, me shpjegimet dhe saktësimet e tij gjatë hetimit administrativ, ka shprehur dhe provuar se nga ky total, 700.000 lekë, është depozituar në sistemin bankar (blerje bonosh thesari) dhe diferenca është gjendje *cash*, afërsisht 120.000 lekë. Pra, vlera prej 700.000 lekësh është kursim, por brenda sistemit bankar dhe vetëm vlera prej 120.000 lekësh është kursim i mbajtur në shtëpi.

13.3. Në lidhje me deklarimin e bërë nga subjekti i rivlerësimit në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 03.07.2009, në vlerësimin tim, subjekti ka sqaruar kursimet familjare të tij dhe të bashkëshortes, duke dhënë shpjegime për gjendjen *cash* në fund të vitit 2007, si dhe ka pasqyruar faktin se diferencën tjetër të kursimeve familjare e ka investuar në bono thesari. Nga leximi dhe analizimi i procesverbalit të mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2009, nuk konstatova që subjekti të jetë shprehur apo dhe nënkuptuar se kursimi i deklaruar në DPV-në e vitit 2007, është kursim në gjendje *cash*, dhe që investimet në bono thesari në këtë vit janë kryer me kursimin gjendje *cash* të deklaruar në DPV-të pararendëse. Subjekti lë të kuptohet se është çështje teknike, mospasqyrimi i pakësimit të gjendjeve *cash*, por se ai ka pasur mundësi kursimesh. Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit, i pranuar edhe nga Komisioni, se shuma 820.205 lekë përfaqëson kursimet familjare në total, nga të cilat në sistemin bankar janë 700.000 lekë (fakt ky i provuar nga verifikimi i dokumentacionit bankar) dhe jashtë tij 120.000 lekë, në vlerësimin tim është i besueshëm.

13.4. Në përfundim të kësaj analize, vlerësoj se në asnjë nga rubrikat/seksionet në DPV-2007, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 820.205 lekë, por vetëm ka paraqitur vlerën totale të kursimeve vjetore nga paga. Bazuar në të dhënat reale të paraqitura nga subjekti në

DPV-2007, nga procesverbali i mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2009, analiza financiare për vitin 2007 nuk del me balancë negative në shumën (-) 744.494 lekë, por me tepriçë në shumën (+) 228.854 lekë, sipas vendimit të Komisionit dhe (+) 341.216 lekë nga kontrolli i analizës në Kolegj, nëse gjendja e kursimeve *cash* konsiderohet në shumën 120.000 lekë, sipas saktësimeve të subjektit.

14. Nga leximi i vendimit të shumicës së trupit gjykues, të krijohet perceptimi se përgjatë viteve 2005, 2006, 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dy vlera kursimi:
 - Për vitin 2005, subjekti ka kursime në shumën 400.000 lekë, që janë gjendje fakti në sistemin bankar dhe, sipas leximit nga shumica, ka edhe shumën 400.000 lekë jashtë sistemit. *Pra, për vitin 2005, shumica arsyeton se subjekti ka kursime në shumë 800.000 lekë, ndërkohë që të ardhurat për këtë vit janë në total 1.202.637 lekë.*
 - Për vitin 2006, subjekti ka kursime në shumën 700.000 lekë, që janë gjendje fakti në sistemin bankar dhe, sipas leximit nga shumica, edhe shumën 700.000 lekë jashtë sistemit. *Pra, për vitin 2006, shumica arsyeton se subjekti ka kursime në shumën 1.400.000 lekë, ndërkohë që të ardhurat për këtë vit janë në total 1.356.663 lekë.*
 - Për vitin 2007, subjekti ka kursime në shumën 700.000 lekë bono thesari, që janë gjendje fakti në sistemin bankar dhe, sipas leximit nga shumica, edhe shumën 820.000 lekë jashtë sistemit. *Pra, për vitin 2007, shumica arsyeton se ka kursime në shumën 1.500.000 lekë, ndërkohë që të ardhurat për këtë vit janë në total 1.581.715 lekë.*
15. Në vijim të arsytimit dhe argumenteve të mia si pakicë, kam vlerësuar se, nëse subjekti do të kishte gjendje shumën *cash* në vlerën prej 1.920.205 lekësh për vitet 2005, 2006, 2007, nëse deklaratat periodike vjetore interpretohen si shtesa të gjendjes *cash*, ai nuk kishte arsye pse në vitin 2008 të merrte hua shumën prej 10.000 eurosh, e cila u përdor për të plotësuar këstin e parë në vlerën prej 25.000 eurosh. Gjithashtu, në asnjë rast Komisionerja Publike dhe shumica e trupit gjykues nuk kanë trajtuar se çfarë ka afektuar kjo shumë në pasurinë e krijuar nga subjekti për vitet në vijim, në kohën kur i vetmi investim që ka kërkuar kryerjen e shpenzimeve në vlera të mëdha, ka qenë blerja e apartamentit në vitin 2010 dhe për periudhën 2005-2007, nuk kanë rezultuar shpenzime ku të jetë materializuar kjo shumë hipotetike në vlerën 1.235.663 lekë. Nga hetimi administrativ dhe gjykimi në Kolegj, nuk u evidentua që subjekti të ketë bërë blerje në shuma të mëdha, të ketë pasur stil jetese apo shpenzime dukshëm të pajustificuara.
16. Nga ana tjetër, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë koherent me deklaratimet dhe shpjegimet e tij në çdo përgjigje që ka dhënë gjatë hetimit administrativ në Komision, duke filluar që nga pranimi hapur i faktit që mënyra e deklarimit në deklaratat periodike vjetore ka qenë një moskuptim/perceptim i gabuar prej tij, duke bërë një saktësim të konceptit “kursime” në DPV-të ndër vite, i cili përmbledhonte edhe likuiditetin në bankë, edhe gjendjet *cash* në banesë dhe që është deklaruar i tillë i njëjtë në të gjitha vitet e deklarimit deri në vitin 2011. Gjithashtu, rezulton e provuar se subjekti nuk ka ndryshuar asnjë shifër nga ato që ka deklaruar në DPV-të respektive, por vetëm i ka qartësuar dhe detajuar me saktësimin për “vlera në bankë” dhe “vlera në *cash*”. Në vijim të këtij argumenti, çmoj se nëse do të bëhet një lexim dhe analizë logjike e deklarimeve periodike ndër vite, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ lidhur me gjendjen *cash*, në pyetësin standard, në pyetësin nr. 2, në

parashtrimet pas rezultateve të hetimit në Komision, si dhe në parashtrimet në Kolegj, ato gjejnë harmoni të plotë me situatën e pasqyruar nga subjekti në deklaratën *vetting*.

17. Në lidhje me konstatimet për sa i përket procesverbalit mbajtur pranë ILDKPKI-së, në procesverbalin e datës 14.2.2013, të cilin Komisionerja Publike në ankim dhe shumica e trupit gjykues në vendim i kanë dhënë peshë për të penalizuar subjektin për shkarkim, rezulton se subjekti ka sqaruar: [...] *kam pakësuar kursimet nga gjendja cash, shumën 1.600.000 lekë, të akumuluar nga puna ndër vite imja dhe b/shortes deri në vitin 2011, për pagesën e shumës 31.000 euro për apartamentin, dhe shuma e mbetur cash pas kësaj është 1.500.000 lekë.* Për sa më sipër, konstatohet se në këta paragrafë ka dy gabime materiale, të bëra nga personi i cili ka mbajtur procesverbalin (edhe pse subjekti duhet t'i kishte konstatuar vetë në momentin e firmosjes së procesverbalit). Konkretisht, shuma e paraqitur si pagesë për apartamentin gjendet e shkruar 31.000 euro, ndërkohë që ajo e saktë është 36.000 euro. Po kështu, një tjetër gabim material është në paraqitjen e shumës 1.500.000 lekë, si të mbetur cash në banesë, të cilat nuk janë mbajtur në konsideratë nga shumica si rrethanë që lehtëson “deklarimin kontradiktor” të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, shumica nuk ka mbajtur në konsideratë as rrethanën që kjo pyetje në procesverbal nuk ka relevancë me shkakun e ankimit, i cili është ngritur nga Komisionerja Publike vetëm për kështin e parë të apartamentit, ndërsa ky procesverbal referon shpjegimet e subjektit për kursimet cash për kështin e dytë, i cili nuk përbën shkak ankimi.
18. Nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, kjo shumë nuk mund të ekzistonte në fund të vitit 2011, pasi:
 - a) referuar DPD-ve, deklarimit në deklaratën *vetting*, si dhe në të gjitha përgjigjet e dhëna prej subjektit gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton të ketë ekzistuar një gjendje likuiditeti cash në shumën 1.500.000 lekë;
 - b) nuk rezulton asnjë e dhënë, e dalë gjatë deklarimeve në DPV, deklarimit në deklaratën *vetting* dhe as nga shpjegimet gjatë hetimit administrativ, që kjo shumë të ketë shërbyer si burim krijimi për ndonjë pasuri apo për të përballuar ndonjë transaksion financiar, në vitet pasardhëse;
 - c) në vitin 2011, subjekti ka finalizuar blerjen e apartamentit, ku si burim për pagesën e kështit prej 36.000 eurosh, ka pasur të gjitha kursimet e mbetura në fund të vitit 2010, kursimet e vitit 2011, si dhe huanë në vlerën 3.000.000 lekë. Në këto rrethana, sërish risjell argumentin se nuk ka asnjë logjikë që për sa kohë subjekti do të dispononte vlerën prej 1.500.000 lekësh, të merrte një hua në vlerën 3.000.000 lekë, për të plotësuar vlerën totale të paguar.
19. Gjatë shqyrtimit të çështjes, me kërkesën time si relatore, njësia e shërbimit ligjor në Kolegj, ka kryer një analizë financiare me qëllim vlerësimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të kursyer gjatë periudhës 2004 – 2008. Në analizë janë përfshirë të ardhurat, shpenzimet e vlerësuara për këtë periudhë, si dhe gjendjet përkatëse në llogaritë bankare. Nga kjo analizë, rezulton se të ardhurat e subjektit dhe personit të lidhur kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës, për të krijuar kursime dhe për të justifikuar gjendjet në llogaritë bankare. Vetëm për vitin 2006, është konstatuar një balancë negative e papërfillshme prej (-) 102.276 lekësh, ndërsa për vitet 2004, 2005, 2007 dhe 2008 janë evidentuar teprica, përkatësisht në vlerat (+) 616.185 lekë, (+) 311.107 lekë, (+) 228.854 lekë

dhe (+) 4.487.204¹⁸ lekë. Në vlerësimin tim, kjo balancë negative nuk mund të interpretohet si një tregues i mungesës së burimeve të ligjshme për periudhën në fjalë. Përkundrazi, analiza tregon se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme dhe teprica totale për periudhën 2005 – 2008, ka qenë në shumën (+) 5.643.350 lekë, në vend të një mungese prej (-) 1.235.663 lekësh; subjekti ka pasur në dispozicion një tepricë burimesh të ligjshme, sikurse rezulton nga tabela e mëposhtme.

Tabela e analizës financiare mbi mundësinë e subjektit dhe b/shortes për të kursyer

NR.	Përshkrimi/vitet:	2004	2005	2006	2007	2008
1	Shtim/pakësim likuiditete bankë	173.958	456.345	876.134	703.684	(2.070.752)
A	PASURI:	173.958	456.345	876.134	703.684	(2.070.752)
2	Huamarrje 10.000 euro, datë 12.12.2008, nga A.V.	-	-	-	-	1.231.600
3	Kredi Entjola Pano PCB disbursed 10.12.2008	-	-	-	-	400.000
B	DETYRIME	-	-	-	-	1.631.600
C	PASURI NETO	173.958	456.345	876.134	703.684	(3.702.352)
4	Të ardhura nga paga e subjektit	596.808	748.254	836.237	866.094	871.798
5	Të ardhura paga b/shortes	518.041	407.768	561.441	570.328	726.954
6	Të ardhura interesa e BTH/depozita	36.488	46.545	58.872	145.294	15.120
D	Të ARDHURA	1.151.337	1.202.567	1.456.550	1.581.716	1.613.872
7	Shpenzime jetese	211.194	328.671	328.671	522.222	409.860
8	Shpenzime udhëtimi TMS	-	16.444	264.021	126.956	19.160
9	Shpenzime -principal+interes në PCB	-	-	-	-	-
10	Shpenzime rinovim banese/arredim	150.000	90.000	90.000	-	400.000
E	SHPENZIME	361.194	435.115	682.692	649.178	829.020
F	Mundësia për kursime cash (Teprica pozitive)¹⁹: (F) = (D) - (C) -(E)	616.185	311.107	(102.276)	228.854	4.487.204

20. Në përfundim të analizës së mësipërme, *lidhur me diferencën negative në shumën 1.235.663 lekë, gjatë viteve 2005, 2006, 2007, unë gjykoj se shkaku i ankimit të Komisioneres Publike është i pazabuar.*

Lidhur me mosdeklarimin e posedimit në cash të shumës së pretenduar si burim prej 1.797.500 lekësh, e krijuar nga tërheqja nga llogaria bankare e bonove të thesarit në vitin 2008

21. Ne, gjyqtaret Mimoza Tasi dhe Albana Shtylla, lidhur me shkaku të ankimit të Komisioneres Publike për mosdeklarimin e posedimit në cash të shumës së pretenduar si burim, prej 1.797.500 lekësh, e krijuar nga tërheqja nga llogaria bankare e bonove të thesarit në vitin 2008, jemi bazuar në një vlerësim harmonik të fakteve dhe provave të cilat çojnë në një përfundim të ndryshëm nga ai i shumicës së trupit gjykues.

¹⁸ Në këtë rezultat është përfshirë tërheqja e shumës 1.797.500 lekë nga bonot e thesarit, kredia në shumën 400.000 lekë dhe huaja prej 10.000 eurosh (ekv. 1.231.600 lekë). Nëse nga rezultati do të zbrisnim këto vlera, atëherë mundësia për kursime jashtë sistemit bankar e subjektit do të rezultonte 1.058.104 lekë për vitin 2008.

¹⁹ Këto teprica nuk janë të deklaruara si kursim jashtë sistemit bankar, por është mundësia për krijimin e kursimeve.

22. Në funksion të vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit, të përdorura për pasurinë apartament me sipërfaqe 98,2 m², u verifikuan dhe analizuan me detaje, ndër të tjera:
- DPV-të e subjektit për vitet 2008, 2009 e 2010, të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, të cilat në këtë proces kanë vlerën e provës, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016; si dhe
 - procesverbalet e mbajtura nga ILDKPKI-ja në kuadër të kontrolleve dhe hetimit administrativ të kryer prej tij ndër vite.
23. Ne gjyqtarët në pakicë, së pari theksojmë se Komisionerja Publike, në paragrafin 20 (ii) të ankimit, nuk ka ngritur shkak ankimi për burimet financiare të ligjshme të bonove të thesarit, pra ajo në asnjë rast nuk ka vënë në dyshim burimin e krijimit të tyre. Gjithashtu, Komisionerja në ankimin e paraqitur në Kolegj, nuk ka paraqitur një analizë, lidhur me mundësinë e krijimit me burime financiare të ligjshme të bonove të thesarit, në momentin e depozitimit të shumave në vitet përkatëse (qershor 2005, 2006 dhe 2007), por ka paraqitur një analizë për vitet në të cilat ato janë krijuar. Për më tepër, Komisionerja Publike, në analizën e viteve 2005, 2006 dhe 2007, me të cilën është njohur e mbrojtur edhe subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, ka konkluduar për mungesë të burimeve financiare të ligjshme në këto vite për të kryer shpenzime dhe realizuar kursime, duke deduktuar që mungesa e burimeve financiare të ligjshme të cilat rezultojnë në këto vite, nuk mund të mbulojë shpenzimet dhe kursimet, por nuk afekton burimet e likuiditeteve/bono thesari.

Ne gjyqtarët e pakicës, në verifikim të analizës së Komisioneres Publike, me të cilën u njoh dhe u mbrojt edhe subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, kemi vlerësuar se edhe në versionin që deklarimet e subjektit në DPV-të e viteve 2005, 2006 dhe 2007 do të lexoheshin ashtu si ka vlerësuar shumica e trupit gjykues në vendim²⁰, mungesa e burimit financiar të ligjshëm në vitin përkatës, nuk afekton shumat e investuara në bono thesari. Në vlerësimin tonë, analiza e trajtuar në vijim, shpjegon edhe qëndrimin e Komisioneres Publike për moskonsiderim si burim për pagimin e këstit të parë të pasurisë apartament, shumë prej 1.797.500 lekësh, e tërhequr nga bonot e thesarit, jo për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme, por vetëm për shkak të mosdeklarimit të saj si gjendje *cash* në DPV-në e vitit 2008 dhe pakësim në DPV-në e vitit 2010.

23.1 Në vitin 2005, sipas Komisionerit Publik dhe shumicës në vendim, subjekti ka një mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën rreth 88.893 lekë, ndërkohë që në këtë vit, sipas Komisionerit, por edhe shumicës në vendim, ai ka investuar në bono thesari shumë prej 300.000 lekësh dhe ka deklaruar kursime në *cash* në shumën 400.000 lekë. Ne gjyqtarët në pakicë kemi vlerësuar se mungesa e burimeve e konstatuar nga Komisioneri në konkluzione, por dhe nga shumica në vendim për vitin 2005, afekton mundësinë e subjektit vetëm lidhur me shpenzimet dhe kursimet në *cash* të deklaruara në këtë vit, duke konkluduar që ai ka pasur

²⁰ Gjyqtare Albana Shtylla ka mbajtur të njëjtin qëndrim si shumica për deklarimet e kursimeve të subjektit në këto vite.

burime financiare të ligjshme për investimin në bono thesari në shumën 300.000 lekë, si dhe burime të ligjshme për kursimet në *cash* vetëm në shumën prej 311.107 lekësh²¹.

23.2. Për vitin 2006, mungesa e burimeve financiare të ligjshme të subjektit, nga analiza e Komisioneres Publike dhe shumicës në vendim, rezulton rreth 402.276 lekë. Në këtë vit subjekti i rivlerësimit, sipas Komisioneres, por edhe shumicës në vendim, ka investuar shumën 400.000 lekë në bono thesari dhe ka deklaruar 700.000 lekë gjendje *cash*. Ne gjyqtaret në pakicë kemi vlerësuar se mungesa e burimeve e konstatuar nga Komisionerja në konkluzione, por dhe nga shumica në vendim për vitin 2006, nuk afekton mundësinë e subjektit lidhur me investimin në bono thesari, duke konkluduar se shuma prej 311.107 lekësh²² nga 400.000 lekë e deklaruar si e investuar në këto bono, ka burime të ligjshme. Në vlerësimin tonë, mungesa e burimeve financiare të ligjshme, e konstatuar si më sipër për këtë vit, në shumën rreth 402.276 lekë, afekton vetëm shpenzimet dhe kursimet *cash* të deklaruara në këtë vit, duke konkluduar që subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme për kursimet *cash* vetëm në shumën prej rreth 297.724 lekësh²³. Ne gjyqtaret në pakicë, në konsideratë të faktit se vlera e mungesës për investimin në bono thesari gjatë këtij viti, ishte në masën 88.893 lekë, çmuam se ajo ishte jodomethënëse për të afektuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të këtyre likuiditeteve.

23.3 Për vitin 2007, mungesa e burimeve financiare të ligjshme e subjektit, nga analiza e Komisioneres Publike dhe e shumicës në vendim, rezulton rreth 744.494 lekë. Në këtë vit, subjekti i rivlerësimit – sipas Komisioneres, por edhe shumicës në vendim – ka investuar në bono thesari shumën 700.000 lekë dhe ka deklaruar 820 mijë lekë gjendje *cash*. Ne gjyqtaret në pakicë kemi vlerësuar se mungesa e burimeve e konstatuar nga Komisionerja në konkluzione, por dhe nga shumica në vendim për vitin 2008, afekton mundësinë e subjektit vetëm lidhur me shpenzimet dhe kursimet në *cash* të deklaruara në këtë vit, duke konkluduar që ai ka pasur burime financiare të ligjshme për investimin në bono thesari në shumën 700.000 lekë, si dhe burime të ligjshme për kursimet në *cash* vetëm në shumën prej 75.711 lekësh²⁴.

24. Në vijim të analizës së mësipërme, ne gjyqtaret në pakicë kemi vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për investimet në shumën 1.797.500 lekë në bono thesari në vitet 2005, 2006 dhe 2007.

Duke qenë se shkaku i ankimit i Komisioneres Publike për bonot e thesarit është i lidhur vetëm me mosdeklarimin si gjendje *cash* në DPV-në e vitit 2008 të shumës së tërhequr nga bonot e thesarit në gusht 2008, si dhe me mosdeklarimin e pakësimit të saj në DPV-në e vitit 2010, pra

²¹ Vlerë kjo e përllogaritur si diferencë e shumës prej 400.000 lekësh, e konsideruar nga Komisionerja, por edhe shumica në vendim, si kursime në *cash*, me mungesën e burimit të konstatuar prej tyre për këtë vit, në shumën prej 88.893 lekësh [400.000 lekë - 88.893 lekë = 311.107 lekë].

²² Meqenëse subjekti ka deklaruar në DPV-2006 që ka depozituar në bono thesari kursimet nga viti 2005, nga analiza më sipër për vitin 2005, rezultoi se kishte mundësi për kursime *cash* në vlerën prej 311.107 lekësh.

²³ Vlerë kjo e përllogaritur si diferencë e shumës prej 700.000 lekësh të konsideruar nga Komisionerja, por edhe shumica në vendim si kursime në *cash*, me mungesën e burimit të konstatuar prej tyre për këtë vit, në shumën prej 402.276 lekësh [700.000 lekë - 402.276 lekë = 297.724 lekë].

²⁴ Vlerë kjo e përllogaritur si diferencë e shumës prej 820.205 lekësh të konsideruar nga Komisionerja, por edhe shumica në vendim, si kursime në *cash*, me mungesën e burimit të konstatuar prej tyre për këtë vit, në shumën prej 744.494 lekësh [820.205 - 744.494 = 75.711 lekë].

në momentin që janë përdorur për pagimin e këstit të parë për pasurinë apartament, në vijim po paraqesim arsyetimin dhe qëndrimin tonë lidhur me këtë shkak ankimi.

25. Sa i përket mosdeklarimit të kësaj shume si gjendje *cash* në fund të vitit 2008, nga subjekti i rivlerësimit është theksuar fakti se, në konceptin e tij në atë kohë, në seksionin “*Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme*”, duhej të pasqyroheshin vetëm ndryshimet në pasuri, shtesa dhe pakësime. Në këtë rast, nga subjekti është perceptuar se tërheqja e shumave të depozituara në bonot e thesarit (përkatësisht 1.797.500 lekë, tërhequr në datën 14.08.2008 dhe 842.063²⁵ lekë, tërhequr në datën 24.02.2011) nuk përbënte ndryshim të mirëfilltë pasurie, si rezultat i një të ardhure/pasurie likuiditet shtesë, por thjesht një ndryshim të vendit të ruajtjes së këtyre shumave. Përfshirja e kursimeve në sistemin bankar si një gjendje fakti, e dukshme dhe lehtësisht e verifikueshme dhe e konstatueshme nga çdo organ kontrolli, për subjektin e rivlerësimit nuk është perceptuar si detyrim për ta deklaruar si gjendje *cash* pas tërheqjes nga banka.

Ne gjyqtaret në pakicë i kemi gjetur bindëse argumentet e subjektit për mënyrën e të kuptuarit të deklarimeve që duhet të bëheshin në DPV lidhur me ndryshimin, shtesat dhe pakësimet e likuiditeteve. Siç edhe ka rezultuar nga provat e administruara, shuma e disponuar në *cash* nga subjekti në vitin 2008, ishte në vlerë të njëjtë me shumën e cila rezultonte e depozituar në llogaritë e bonove të thesarit²⁶, pra subjekti gjatë vitit 2008 nuk kishte pasur asnjë shtesë/pakësim të pasurisë likuiditet, por thjesht një ndryshim të vendit të ruajtjes së tyre nga sistemi bankar në banesë.

26. Shuma prej 1.900.000 lekësh, transferuar nga bonot e thesarit në qershor të vitit 2008 dhe tërhequr nga banka 1.797.500 lekë (provuar transaksioni me dokumentacionin bankar), në datën 14.08.2008, ndonëse për arsyet e referuara më lart nuk është përmendur në DPV-në e vitit 2008, në vazhdim gjendet e pasqyruar në deklaratimet e shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, sipas:
- (i) procesverbalit të datës 14.02.2013, mbajtur në ILDKPKI, i mbajtur në një periudhë relativisht të afërt në kohë me momentin kur kjo shumë është tërhequr nga banka e përdorur nga subjekti, dhe me deklarime të pandikuara dhe për qëllime të procesit të rivlerësimit;
 - (ii) deklaratimit në deklaratën *vetting*;
 - (iii) në të gjitha përgjigjet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision.
27. Në lidhje me tërheqjen e shumës prej 1.797.500 lekësh dhe mbajtjen e saj si gjendje *cash* deri në shlyerjen e pagesës së këstit të parë në shumën 25.000 euro, subjekti ka dhënë sqarime sërish edhe në procesverbalin e datës 08.03.2016, mbajtur pranë ILDKPKI-së. Në këtë procesverbal, nga subjekti i rivlerësimit është saktësuar pakësimi i shumës 1.900.000 lekë nga llogaria e bonove të thesarit (viti 2008) dhe destinacioni i përdorimit të saj. Gjithashtu, janë paraqitur edhe arsyet se përse nuk ishte shprehur ky pakësim, të cilat janë të njëjta me ato të pasqyruara në paragrafin 23 më sipër. Nga aktet e administruara në fashikull, rezulton i qartë qëllimi i

²⁵ Kjo shumë nga bonot e thesarit është për pagesën e këstit të dytë në vitin 2011, për të cilën edhe pse në të njëjtat kushte dhe rrethana me bonot e këstit të parë, nuk është ngritur shkak ankimi nga Komisionerja Publike duke përbërë një standard të ndryshëm.

²⁶ 1.797.500 lekë, tërhequr në datën 14.08.2008

përdorimit të shumës së përftuar nga tërheqja e bonove të thesarit – prenotimi dhe blerja e një apartamenti banimi nga subjekti i rivlerësimit, për të cilin përpjekjet e para rezultojnë të jenë bërë që në vitin 2008 për shtëpinë ku subjekti jetonte me qira, por që nuk u arrit të finalizohet negociimi. Kjo ishte arsyeja kryesore që bonot e thesarit dhe huaja nga shtetasi A. V. u tërhoqën e morën që në vitin 2008 nga subjekti e, në vijim, u mbajtën për qëllim të blerjes së një apartamenti në të ardhmen).

28. Lidhur me pretendimin e Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit gjithashtu nuk ka deklaruar pakësimin e shumës 1.797.500 lekë në DPV-në e vitit 2008, kemi vlerësuar se ky fakt është evidentuar prej tij më pas, më shumë se një herë. Konkretisht, në vlerësimin tonë për shumën 1.797.500 lekë, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar atë në:
- (i) DPV-në e vitit 2010, ku ai deklaroi qartë se pagesa e kështit të parë të apartamentit, prej 25.000 eurosh, ka si burim edhe kursimet e tij dhe të bashkëshortes ndër vite. Siç edhe është arsyetuar më sipër, kursimet e subjektit në vite kanë qenë të depozituara, ndër të tjera, edhe në bonot e thesarit, të lidhura në mënyrë të pazgjdhshme vetëm me kursimet nga paga.
 - (ii) Procesverbalin e datës 14.02.2013, mbajtur pranë ILDKPKI-së, ku kjo shumë deklarohet si një nga zërat financiarë që kanë plotësuar shumën e përdorur prej tij, për pagesën e kështit të parë të apartamentit, në shumën 25.000 mijë euro, duke nënkuptuar pakësimin e saj në vitin 2010. Në vlerësimin tonë, ky deklarim i subjektit në ILDPKI në vitin 2013, përveçse shumë afër në kohë me vitin kur kjo shumë është përdorur, është konsideruar si një korrigjim i DPV-së së vitit 2010.
 - (iii) Procesverbalin e datës 08.03.2016, mbajtur pranë ILDKPKI-së, ku subjekti saktëson pakësimin e kësaj shume me qëllim përdorimin e saj për pagimin e kështit të parë të pasurisë apartament.
 - (iv) Deklaratën *vetting*, e cila është dokumenti ligjor bazë nga fillon kontrolli i rivlerësimit të pasurisë dhe që, sipas Aneksit të Kushtetutës, duhet të përmbajë me saktësi dhe vërtetësi të dhënat lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit. Pasqyrimi në këtë deklaratë si burim për krijimin e pasurisë apartament, i shumës së tërhequr nga bonot e thesarit, është vlerësuar në mënyrë harmonike me deklaratimet e shpjegimet e sipërcituara të subjektit të rivlerësimit.
29. Në DPV-në e vitit 2010, në seksionin “*Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme*”, subjekti ka deklaruar: “kursime nga paga Erion Pano, viti 2010, 320.000 lekë 50%”, si dhe: “kursime nga paga E. P., viti 2010, 320.000 lekë 50%”. Po në këtë DPV, është deklaruar edhe pagesa e kështit të parë të apartamentit në shumën 25.000 euro. Ne gjyqtaret në pakicë, deri në momentin e pagesës së kështit të parë të pasurisë apartament në shumën 25.000 euro, bazuar në deklarin e kursimeve *cash* të viteve 2007 – 2009, kemi vlerësuar se subjekti ka disponuar shumën 1.320.000 lekë, shumën 10.000 euro të marrë hua nga shtetasi A. V. dhe shumën 1.797.500 lekë të tërhequr *cash* nga bonot e thesarit.
30. Gjithashtu, në krijimin e bindjes se shuma prej 1.797.500 lekësh ka qenë disponuar deri në vitin 2010 dhe është pakësuar në po këtë vit për pagesën e kështit të parë të pasurisë apartament, në një vlerësim tërësor të të gjitha rrethanave të çështjes, kemi konstatuar se:
- (i) subjekti në asnjë dokument apo rrethanë tjetër, nuk ka deklaruar a pranuar shpenzimin e menjëhershëm apo aty për aty, të kësaj shume të përfituar nga pakësimi i bonove të thesarit;

(ii) periudha e disponimit të kësaj gjendjeje *cash* është e shkurtër [prej rreth 2 vitesh] dhe gjatë saj nuk ka indicie që kjo shumë të jetë shpenzuar në të njëjtin vit kalendarik (2008), a në vitet pasardhëse (2009 – 2010), pasi nuk janë evidentuar shpenzime apo pasuri të krijuara gjatë këtyre viteve.

Bazuar në sa më sipër, kemi konkluduar se shuma prej 1.797.500 lekësh i është shtuar gjendjes së kursimeve të tjera *cash* (huasë në vlerën 10.000 euro dhe kursimeve në vlerën 1.320.000 lekë).

31. Lidhur me qëndrimin e shumicës për kredinë e përfituar nga subjekti në vitin 2008, duke e konsideruar atë si një rrethanë me ndikim në drejtim të krijimit të bindjes për ekzistencën apo jo si gjendje *cash* të shumës prej 1.797.500 lekësh në vitin 2008, fillimisht theksojmë se sjellja financiare e subjekteve në drejtim të përdorimit të burimeve të ndryshme për përballimin e shpenzimeve/investimeve të caktuara, siç janë edhe kreditë, në kushtet kur kanë në disponim në të njëjtën kohë kursime në *cash* apo në llogari bankare, nuk mund të passjellë konkluzionin që subjekti nuk është i besueshëm në ekzistencën reale të këtyre kursimeve. Pra, çdo individ është i lirë të diversifikojë dhe përdorë për një shpenzim/investim burime financiare që ai i konsideron më të leverdisshme për qëllimet dhe interesin e tij, pa u kushtëzuar që domosdoshmërisht duhet të përdorë burimet që ka gjendje. Në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se paratë e shpenzuara për mobilimin e shtëpisë, janë të shtrira në kohë që nga martesa në vitin 2004 dhe kanë vijuar në vitet 2005, 2006. Ne gjyqtaret në pakicë kemi vlerësuar se kredia e marrë në vitin 2008, është përdorur në funksion të blerjeve të pajisjeve elektroshtëpiake, orendi, si dhe mobilie (duke mbajtur në konsideratë se subjekti banonte me qira në një apartament të ri, të cilin kishte synuar edhe që ta blinte), por në ndryshim nga shumica kemi konkluduar se përfitimi i kësaj kredie nuk mund të passjellë konkluzionin që kjo rrethanë provon se shuma prej 1.797.500 lekësh nuk ka ekzistuar në vitin 2008.
32. Shumica ka shprehur se në DPV-të e viteve 2010-2011, subjekti i rivlerësimit, si një ndër burimet për blerjen e apartamentit, ka deklaruar dhe kredi, burim ky i cili në deklaratën *vetting* nuk është deklaruar. Nga fashikulli i Komisionit, rezulton se e vetmja kredi e marrë nga subjekti është ajo e marrë në shumën 400.000 lekë në vitin 2008, për të cilën në DPV-2008, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ai ka deklaruar: *Rinovim banese (blerje pajisje shtëpiake), Kredi Bankare Banka Pro-CREDIT, 400.000 lekë principal + interes 94.400 lekë, kohëzgjatja 30 muaj dhe kësti mujor 16.700 lekë. Data e kredisë 10.12.2008.*
33. Në analizë të deklarimeve të sipërcituara të subjektit në DPV-të e viteve 2008, 2010 dhe 2011, si dhe qëllimit të përdorimit të saj, kemi konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta në këto vite. Në vlerësimin tonë, nëse subjekti do të kishte për qëllim që të justifikonte burimet financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament, ai do të kishte përdorur kredinë për këtë qëllim. Ne gjyqtarët në pakicë kemi çmuar se “mosdeklarimi” në deklaratën *vetting*, i këtij burimi të ligjshëm, kredisë, dëshmon të kundërtën e asaj që pretendon shumica, pra mungesën e përpjekjes apo qëllimit të subjektit për të shtuar/ndryshuar burimet e pagesës së apartamentit, me qëllim justifikimin e tyre. Sjellja në vendim nga shumica e pasaktësisë në DPV, pra e deklarimit të kredisë si burim, edhe pse kjo kredi nuk afekton analizën e shkaqeve të ankimit të Komisioneres Publike, duke i dhënë peshë në drejtim të

krijimit të bindjes lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, rëndon në mënyrë të padrejtë pozitën e subjektit në funksion të procesit të rivlerësimit.

34. Në vlerësimin tonë, subjekti ka pranuar si gjatë procesit në Komision, ashtu edhe gjatë gjykimit në Kolegj faktin që në plotësimin e deklarimeve periodike vjetore, duhet të kishte treguar më tepër kujdes në specifikimin e fjalës “kursime *cash*”, në evidentimin e pakësimit të bonove të thesarit dhe shtesën e likuiditeteve *cash* (nga tërheqja e bonove). Kjo ka ardhur për shkak të moskuptimit të drejtë të mënyrës së plotësimit të deklaratave periodike lidhur me shtesat dhe pakësimet. Ritheksojmë faktin se, në të gjitha episodet ku evidentohen pasaktësi, ato qartazi janë korrigjuar/saktësuar në shpjegimet e dhëna nga subjekti në deklaratën *vetting* dhe gjatë hetimit administrativ të Komisionit, por edhe me shpjegimet e dhëna nën këtë kuadër sipas legjislacionit të kohës me anë të akteve/procesverbaleve të kontrollit pranë organit kompetent, ILDKPKI-së, shpjegime të cilat kanë shëruar këtë defekt në raport me provueshmërinë e faktit. Deklarimet e subjektit në këto dokumente janë analizuar në tërësi me të gjitha të dhënat që rezultojnë nga të gjitha aktet e tjera të administruara në proces, e kanë sjellë informacion të vlefshëm me vlerë provuese për disa nga rrethanat e padeklaruara në deklaratën periodike. Në asnjë rast nuk u provua deklarimi qëllimshëm në mënyrë të pasaktë i kësaj pasurie apo i ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurisë. Konstatohet se mosdeklarimi i këtij fakti juridik nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike, nuk pamundësoi institucionet e rivlerësimit për kontrollin dhe verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve të tij në deklaratën e rivlerësimit, lidhur me pasurinë e deklaruar dhe mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e saj.

Në këtë kuptim, mosdeklarimi i pakësimit të bonove të thesarit në vitin 2010, konsiderohet një pasaktësi në deklarim që nuk përfaqëson realisht ecurinë e situatës financiare të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë mbështetur edhe në rezultatin e analizës financiare të kryer, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi që të krijonte kursimet në *cash* të deklaruara në fund të vitit pararendës e, për rrjedhojë, t'i përdorte ato për krijimin e pasurive objekt kontrolli.

35. Sjellim në vëmendje qëndrimet tanimë të konsoliduara të Kolegjit të Posaçëm të Apelit²⁷, në lidhje me faktin se pasaktësitë në deklarime, për sa kohë që nuk shoqërohen me mungesa të burimeve të ligjshme për të krijuar pasurinë *cash* apo pasuri të tjera të deklaruara vit pas viti, nuk mund të kualifikohen si asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe të përbëjnë për pasojë një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Siç edhe kemi analizuar e vlerësuar më sipër, kursimet e depozituara në bono thesari dhe të tërhequra në vitin 2008, janë krijuar me burime të ligjshme, ndaj pasaktësitë në deklarimin e gjendjes *cash* dhe pakësimit të saj, përkatësisht në DPV-të e viteve 2008 dhe 2010 nuk mund të passjellin konkluzionin për deklarim të pamjaftueshëm të subjektit të rivlerësimit për krijimin e pasurisë apartament e, për rrjedhojë, shkarkimin e tij.

²⁷ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 4/2023, datë 16.02.2023 (JR); nr. 36/2022, datë 30.09.2022 (JR); nr. 35/2022, datë 22.09.2022 (JR); nr. 27/2022, datë 06.07.2022 (JR); nr. 24/2022, datë 28.07.2022 (JR); nr. 20/2022, datë 14.06.2022 (JR); nr. 1/2022, datë 27.01.2022 (JR); nr. 33/2021, datë 03.11.2021 (JR); ; dhe nr. 9/2020, datë 26.06.2020 (JR).

Ky konkluzion mbështetet edhe në mënyrën se si Kolegji ka trajtuar raste të ngjashme lidhur me pasaktësitë në deklarimin e gjendjes *cash*. Konkretisht, në vendimin nr. 29/2022, datë 21.07.2022 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. E. D., Kolegji ka arsyetuar se: [...] *pasaktësia e deklarimeve periodike nuk përbën shkak për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë objekt kontrolli, deklaruar saktë e plotësisht në deklaratën e rivlerësimit, pasi nuk ka rezultuar asnjë e dhënë, sipas së cilës mosdeklarimi i posedimit në cash të shumës prej 5.000.000 lekësh në vitet 2007 dhe 2008 dhe përdorimi i saj në vitin 2009, të ketë shërbyer për fshehjen e veprimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, në kundërshtim me detyrimet e tij, sipas legjislacionit në fuqi, për deklarimin e pasurive [...].* Në të njëjtën logjikë, Kolegji ka arsyetuar në vendimin nr. 37/2021, datë 24.11.2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit S. N., sipas të cilit: [...] *subjekti nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për pasaktësi në deklarimet periodike, për sa kohë që justifikohet bindshëm mundësia që ai të krijonte këtë pasuri me burime të ligjshme.* Edhe në vendimin nr. 14/2021, datë 15.06.2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. I. B., Kolegji konfirmon se: [...] *subjekti nuk ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e këtij likuiditeti në gjendje cash, duke arritur në përfundimin se një pasaktësi e tillë në deklarimin periodik të vitit 2009, nuk sjell asnjë efekt në kuadër të vlerësimit të kriterit të pasurisë dhe, për rrjedhojë, nuk përbën shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.* Po ashtu, në vendimin nr. 28/2020, datë 23.10.2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit F. V, Kolegji ka konfirmuar qëndrimin se: [...] *edhe në versionin që do të qëndronte konkluzioni i Komisionit se subjekti në të paktën katër deklarata periodike ka deklaruar në mënyrë të pasaktë gjendjen e tij të cash-it, për sa kohë që këto pasaktësi nuk shoqërohen me mungesa të burimeve të ligjshme për të krijuar pasurinë cash apo pasuri të tjera të deklaruara vit pas viti, nuk mund të kualifikohen si asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe të përbëjnë për pasojë një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.*

36. Vendimi i shumicës së trupit gjykues për ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe shkarkimin e subjektit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, pavarësisht se analiza financiare vërtetoi që deklarimi në deklaratën *vetting* ishte i mbështetur me shpjegimet e dhëna nga subjekti në procesverbalet e ILDKPKI-së, në gjykimin tonë paraqet një qasje joproporcionale dhe rënduese, në raport me gjithë rrethanat lehtësuese që provoi hetimi në Komision dhe gjykimin në Kolegj. Edhe në versionin kur rezulton mungesë e burimeve të ligjshme në vitet 2005, 2006 dhe 2007 në shumën totale prej 1.235.000 lekësh, në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, kemi vlerësuar se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në përmbushjen e këtij kriteri. Në këtë vlerësim, ne gjyqtarët e pakicës kemi marrë në konsideratë se: (i) mungesa e burimeve financiare të ligjshme është e shpërndarë në 3 vite; (ii) bëhet fjalë për një pasuri të vetme me sipërfaqe modeste; dhe (iii) mungesa e burimeve financiare të ligjshme nuk afekton burimet e krijimit të pasurisë apartament.
37. Në përfundim, ne gjyqtarët në pakicë çmojmë të thërrasim për zbatim për zgjidhjen e kësaj çështjeje parimin e proporcionalitetit, si një ndër parimet më themelore të së drejtës dhe që është instrumenti kryesor për analizën dhe ruajtjen e balancës në drejtim të interesave në çdo rast kur merret një vendim në zbatim të normave juridike. Parimi i proporcionalitetit zë një vend të rëndësishëm në hierarkinë e parimeve juridike dhe për funksionimin e sistemit të së

drejtës, i cili mishërohet në nenin 17 të Kushtetutës, si dhe është një parim themelor që ka gjetur shprehinë e tij në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të së Njeriut, si dhe në praktikën e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut [të cilat janë burime të detyrueshme të së drejtës në vendin tonë të rangut kushtetues]. Gjykata Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ka një praktikë tepër të pasur, në të cilën ka sqaruar siç duhet kuptimin dhe funksionin e këtij parimi. Ky parim është thelbësor edhe në procesin gjyqësor dhe në çdo proces vendimmarrjeje, të cilat zgjidhin mosmarrëveshje apo njohin të drejta dhe interesave të ligjshëm të subjekteve të së drejtës, nëpërmjet drejtpeshimit të interesave sipas logjikës së rëndësisë së tyre në raport me shoqërinë dhe interesin e përgjithshëm të saj.

38. Bazuar në kuptimin e parimit të proporcionalitetit, si një formë e dhënies së drejtësisë, barazisë së subjekteve para ligjit dhe balancës së të drejtave dhe interesave të tjerë të ligjshëm, gjykata sa herë që merr vendim, duhet të balancojë të drejtat dhe interesat e tjerë të ligjshëm të palëve midis tyre dhe midis interesave të përgjithshëm të shoqërisë të parashikuar në ligj, ose balancim të të drejtave dhe interesave të tjerë të ligjshëm të palës dhe atyre të përgjithshëm të shoqërisë. Në konsideratë të këtij parimi, edhe në versionin që subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për vitet 2005-2007, në shumën prej 1.235.663 lekësh, si dhe në vitin 2016 në shumën prej 361.968 lekësh²⁸, referuar edhe standardit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mungesa është në një vlerë të tillë që thërret për zbatim parimin e proporcionalitetit.
39. Në një vështrim të përgjithshëm të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, si rrjedhojë ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica dhe votuam për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 592, datë 24.11.2022.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

²⁸ Sipas qëndrimit të mbajtur edhe nga gjyqtare Albana Shtylla, pjesë e këtij mendimi pakice.